



# Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar

2017/2018

Ky program trajnimi është miratuar nga Këshilli Drejtues, i Institutit Gjyqësor të Kosovës me datën 06 shkurt 2017.



Publikuar nga Akademia e Drejtësisë

© AD 2017, Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.  
Përmbajtja e këtij materiali mund të përdoret për qëllime edukative dhe jo-komerciale duke ju referuar AD-së si burim. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi apo çfarëdo forme tjetër e publikimit pa konfirmimin e AD-së.

### **Sqarim:**

Ligji për Akademinë e Drejtësisë Nr. 05/L-095, i cili ka hyrë në fuqi me datë 24 shkurt 2017, transformon Institutin Gjyqësor të Kosovës në Akademi të Drejtësisë. Ky program është miratuar nga Këshilli Drejtues i IGJK-së para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Meqë ky program publikohet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kudo që është përdorë emërtimi Instituti Gjyqësor i Kosovës nënkupton Akademinë e Drejtësisë.

## Tabela e përmbajtjes

|  |    |
|--|----|
| 1. Hyrje .....   | 5  |
| 2. Synimet kryesore të programit trajnues .....                              | 6  |
| 3. Baza ligjore .....  | 7  |
| 4. Metodologjia e hartimit të programit të trajnimeve .....                  | 8  |
| 5. Struktura dhe përmbajtja e PTF .....                                      | 9  |
| 5.1 Synimi për kualifikim .....  | 9  |
| 5.2 Struktura e PTF .....  | 9  |
| 5.3 Përmbajtja e PTF .....   | 14 |
| 5.3.1 Pjesa e trajnimit teorik .....   | 15 |
| 5.3.2 Pjesa e trajnimit praktik .....  | 15 |
| 5.4 Program trajnimi në institucionet jo gjyqësore .....                     | 16 |
| 5.5 Simulimet e gjykimeve .....  | 17 |
| 5.6 Puna hulumtuese .....  | 17 |
| 6. Vlerësimi .....   | 18 |
| 6.1 Shembull i vlerësimit nga ana e trajnuesit .....                         | 19 |
| 6.2 Shembull i tabelës së vlerësimit nga ana e Mentorit .....                | 20 |
| 7. Kalendar i orari trajnues .....   | 21 |
| 9. Modulet trajnuese të PTF 2017/2018 për gjyqtarët e sapoemëruar .....      | 22 |
| 10. Modulet trajnuese PTF 2017/2018 .....                                    | 24 |
| 10.1 Rendi juridik kombëtarë dhe ndërkombëtarë .....                         | 24 |
| 10.1.1 E drejta Kushtetuese .....  | 24 |
| 10.1.2 Organizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial .....                  | 25 |
| 10.1.3 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile .....  | 25 |
| 10.1.4 E Drejta e Bashkimit Evropian .....                                   | 26 |
| 10.1.5 Legjislacioni për të drejtat e njeriut - KEDNJ .....                  | 27 |
| 10.2 Kodi Penal i Republikës së Kosovës .....                                | 28 |
| 10.2.1 Kodi Penal – Pjesa e përgjithshme .....                               | 28 |
| 10.2.2 Kodi Penal –Pjesa e veçantë .....                                     | 28 |
| 10.2.3 Veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare ..... | 29 |
| 10.2.4 Krimet e rënda .....  | 29 |
| 10.2.5 Parashkrimi .....   | 30 |
| 10.3 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës .....                  | 31 |
| 10.3.1 Ekspertiza dhe analizat .....   | 31 |
| 10.3.2 Kontrolli dhe konfiskimi .....  | 31 |
| 10.3.3 Masat e Fshehta të Hetimit dhe të Vëzhgimit .....                     | 32 |
| 10.3.4 Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedure .....     | 32 |
| 10.3.5 I pandehuri në procedurë penale .....                                 | 33 |
| 10.3.6 Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale .....               | 34 |
| 10.3.7 Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë .....                 | 34 |
| 10.3.8 Administrimi i procedurës penale .....                                | 35 |
| 10.3.9 Shqyrtimi fillestar i dytë dhe shqyrtimi Gjyqësor .....               | 36 |
| 10.3.10 Marrja dhe komunikimi i vendimeve dhe dërgimi i shkresave .....      | 36 |
| 10.3.11 Shpenzimet e procedurës dhe kërkesat pasurore juridike .....         | 27 |
| 10.3.12 Procedura sipas mjeteve juridike .....                               | 27 |
| 10.3.13 Procedurat e veçanta sipas KPPK .....                                | 38 |
| 10.3.14 Provat në procedurën penale .....                                    | 39 |
| 10.4 E drejta civile, administrative dhe ekonomike .....                     | 40 |
| 10.4.1 E drejta civile .....   | 40 |
| 10.4.2 Procedura Kontestimore - pjesa e parë .....                           | 40 |
| 10.4.3 Procedura kontestimore - pjesa e dytë .....                           | 41 |
| 10.4.4 Procedura jokontestimore .....  | 41 |
| 10.4.5 Procedura përmbartimore .....   | 42 |
| 10.4.6 E drejta administrative .....   | 42 |
| 10.4.7 E drejta e detyrimeve .....   | 43 |

|  |    |
|--|----|
| 10.4.8 E drejta ekonomike .....                                      | 43 |
| 10.4.9 E drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera të përafërta .....  | 44 |
| 10.4.10 E drejta e trashëgimisë .....                                | 45 |
| 10.4.11 E drejta e punës .....                                       | 45 |
| 10.4.12 E drejta familjare .....                                     | 46 |
| 10.4.13 Marrja dhe administrimi i provave në procedurën civile ..... | 46 |
| 10.5 Shkathësitë personale dhe ndërdisiplinare .....                 | 47 |
| 10.5.1 Rregullat e Komunikimit .....                                 | 47 |
| 10.5.2 Etika Profesionale .....                                      | 47 |
| 10.5.3 Menaxhimi i rasteve .....                                     | 48 |
| 10.5.4 Ngritja e shkathësive sociale të gjyqtarëve .....             | 48 |
| 10.5.5 Arsytimi i vendimeve gjyqësore .....                          | 49 |
| 10.5.6 Menaxhimi i stresit .....                                     | 49 |
| 10.6 Legjislacioni dhe shkathësitë plotësuese .....                  | 50 |
| 10.6.1 Kodi i Drejtësisë për të Mitur .....                          | 50 |
| 10.6.2 Ndërmjetësimi .....   | 50 |
| 10.6.3 Zhvillimi i shkathësive gjyqësore .....                       | 51 |
| 10.6.4 Ligji për kundërvajtje .....                                  | 51 |
| 10.7 Mësimi në distance .....  | 52 |
| 10.7.1 Gjuha angleze .....   | 52 |
| 10.7.2 Teknologjia informative .....                                 | 52 |
| 11. Përfundim .....  | 53 |

## 1. Hyrje

Në kuadër të mandatit të tij Instituti Gjyqësor i Kosovës (më tutje IGJK), që nga viti 2008 ka filluar zbatimin e Programit të Trajnimit Fillestar (PTF), duke organizuar trajnimin për profesionistët që hyjnë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial në cilësinë e gjyqtarit dhe prokurorit të ardhshëm pas kalimit me sukses të Provimit Përgatitor të organizuar nga IGJK. PTF është organizuar për pesë gjenerata dhe deri më tani kanë diplomuar 169 kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë.

Ndryshimet në ligjet e gjyqësorit kanë ndikuar në organizimin e PTF-së, si në kategorinë e përfituesve, organizimin e provimit përgatitor dhe kohëzgjatjen e trajnimit fillestar. Sipas këtyre ndryshimeve PTF zgjatë 12 muaj dhe organizohet për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të sapoemëruar ndërsa Provimi Përgatitor organizohet dhe vlerësohet nga KGJK dhe KPK.

Mbështetur në këto ndryshime legjislativë, IGJK ka ndryshuar dhe plotësuar aktet nënligjore të cilat rregullojnë ndarjen dhe përmbajtjen, kohëzgjatjen e trajnimit teorik dhe praktik, vlerësimin gjatë trajnimit në PTF, si dhe ka hartuar programin trajnues në përputhje me nevojat e gjyqtarëve të sapoemëruar.

IGJK objektive kryesore në kuadër të PTF-së për vitin 2017, ka zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe zhvillimin e shkathtësive praktike të gjyqtarëve të sapoemëruar.

Andaj, programi i trajnimit fillestar për gjeneratën e gjashtë do të zbatohet sipas një modeli të kombinuar teorik dhe praktik, përmes aplikimit të metodologjisë bashkëkohore trajnuese ku përfshihen teknikat e mësimit për të rritur, po ashtu trajnimet ofrohen edhe përmes mësimit në distancë.

Për zbatimin e këtij programi trajnues do të hartohen dokumente përcjellëse si: modulet trajnuese, kalendari trajnues, orari i trajnimeve dhe materialet prezantuese për temat konkrete.

Ky program trajnimi është miratuar nga Këshilli Drejtues me datë 6 shkurt 2017.

## 2. Synimet kryesore të programit trajnues

Trajnimi gjyqësor është esencial në funksionimin e një sistemi gjyqësor e prokurorial profesional. Në veçanti mjaft i dobishëm dhe i domosdoshëm vlerësohet edhe trajnimi i gjyqtarëve të sapoemëruar apo trajnimi fillestar siç njihet në terminologjinë e trajnimit gjyqësor dhe konsiderohet si një prej faktorëve kyç në garantimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe kompetencës profesionale e etike të gjyqësorit.

Në programin e trajnimit fillestar për vitin 2017, synimet kryesore janë:

- ◆ Ofrimi i një programi trajnimi adekuat për gjyqtarët fillestar, duke u bazuar në njohuritë ekzistuese të përfituesve;
- ◆ Krijimi i një programi trajnues që reflekton kompetencat dhe detyrat në ushtrimin e profesionit të gjyqtarit;
- ◆ Trajnuesit/mentorët të shërbejnë si lehtësues në procesin e mësim-nxënies duke e konsideruar gjykatën si një institucion edukues;
- ◆ Informimi me punën e institucioneve tjera të sistemit të drejtësisë;
- ◆ Ofrimi i mundësisë për përfituesin, që duke u angazhuar në punë ekipore, të kryejnë hulumtime për zhvillimin e tyre profesional dhe hulumtime në kontribut të zhvillimit të përgjithshëm të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

### 3. Baza ligjore

Ligji për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, është ligj bazë për organizimin e trajnimit fillestar. Dispozita tjera që përcaktojnë dhe mbështesin trajnimin fillestar gjenden edhe në ligjet tjera të cilat e rregullojnë funksionimin e sistemit gjyqësor.

Me qëllim të zbatimit praktik të këtij programi trajnues IGJK përveç koordinimit me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nxjerrë edhe rregulla të brendshme.

Për këtë qëllim IGJK bazohet në:

- ◆ Ligji mbi Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës (Nr. 02-L/25);
- ◆ Ligji për Gjykatat (Nr. 03/L199);
- ◆ Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L199 për Gjykatat;
- ◆ Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223);
- ◆ Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr. 05/L-094);
- ◆ Statuti i IGJK-së;
- ◆ Rregullorja për Programin e Trajnimit Fillestar;
- ◆ Programi i Punës së IGJK-së për vitin 2017 (i miratuar nga Këshilli Drejtues i IGJK-së me datë 06 dhjetor 2016);
- ◆ Udhëzimi Administrativ 01/2012 për Riorganizimin e Brendshëm të IGJK-së.



## 4. Metodologjia e hartimit të programit të trajnimeve

Për hartimin e këtij programi trajnues janë zhvilluar diskutime me përfaqësuesit kryesor të sistemit gjyqësor e prokurorial, me gjyqtarë, prokurorë, trajnues dhe ish kandidatët e PTF. Gjithashtu janë bërë vlerësime të raporteve të institucioneve vendore e ndërkombëtare në Kosovë si dhe janë zhvilluar një sërë mekanizmash për vlerësimin e nevojave për trajnime.

Më poshtë janë të prezantuara disa nga hapat e ndërmarrë me qëllim të hartimit të këtij programi:

- ◆ Konsultimet me Kryetarin e Gjykatës Supreme;
- ◆ Konsultimet me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- ◆ Diskutimet me trajnues të PTF;
- ◆ Konferenca e të Diplomuarve - me ish kandidatët PTF;
- ◆ Vlerësimi i Programit të Trajnimit Fillestar të IGJK-së (i realizuar nga Shkolla e Magjistraturës së Francës, në janar 2015);
- ◆ Pyetësorët e shpërndarë për kandidatët e PTF;
- ◆ Analizimi i strukturës ligjore në fuqi;
- ◆ Praktikat e institucioneve ndërkombëtare të trajnimit etj.

## 5. Struktura dhe përmbajtja e PTF

### 5.1 Synimi për kualifikim

Koncepti i përgjithshëm i synimeve për kualifikim profesional të pjesëmarrësve në PTF është:

- \* Përmbushja e kërkesave të përgjithshme për funksionin e gjyqtarit në Kosovë; (profesionale, metodike, sociale dhe personale), theks në kompetenca sociale dhe personale reflektim të pavarur për çështje gjyqësore, konsiderimi i procedurave alternative, argumentim bindës;
- \* Kompetencat (njohuritë, shkathësitë dhe qëndrimet) e nevojshme për performancë të suksesshme profesionale si gjyqtarë në sistemin gjyqësor në Kosovë;
- \* Aftësia për t'u përballur me kërkesa dhe sfida që ndryshojnë përherë;
- \* Aftësia për të përdorur dhe zbatuar kompetencat e kërkuara drejtpërsëdrejti në punë;
- \* Orientim në çështje praktike dhe vetëdijesim mbi ndërlidhjen në mes të dimensioneve juridike, sociale dhe ekonomike;
- \* Kërkesat për finalizim të suksesshëm (vetë-organizimi dhe disiplina, aftësia për t'u përballur me vëllim të lartë pune);

### 5.2 Struktura e PTF

Pas ndryshimeve të ligjeve të gjyqësorit, trajnimi fillestar zgjatë dymbëdhjetë (12) muaj. Përcaktimi kohor me ligj mundëson që trajnimi të jetë intensiv dhe struktura e programit të trajnimit fillestar për vitin 2017/2018 është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përfshinë trajnimin teorik i kombinuar me shqyrtime të rasteve nga praktika gjyqësore, simulime etj., ndërsa pjesa e dytë është trajnim praktik i shoqëruar edhe me trajnime në institucione jo gjyqësore që lidhen me punën e gjyqtarit dhe prokurorit.

Për të përcaktuar strukturën e trajnimit fillestar duhet përcaktuar fillimisht se cilat kompetenca duhet të zhvillohen tek gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar, përkatësisht duhet të dimë se cilat janë cilësitë që duhet të t'i ketë një gjyqtarë dhe prokurorë.

Për zhvillimin e kompetencave tek pjesëmarrësit e trajnimeve IGJK bazohet në skemën e mëposhtme:

|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>Integriteti personal dhe sjellja profesionale</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pavarësia dhe paanshmëria</li> <li>• Vetëbesimi dhe autenticiteti</li> <li>• Angazhim i ndershëm për një gjykim të drejtë</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>– Është i bindur në lidhje me sistemin ligjor dhe cilësinë e tij;</li> <li>– Përfaqëson vendimin e marrë;</li> <li>– Tregon individualitetin dhe qëndrueshmërinë ndaj ndikimit të veprimeve të veta;</li> <li>– Guxon kur është e nevojshme, për të shkuar kundër pikëpamjeve mbizotëruese;</li> <li>– Është i qartë në lidhje me pritjet, vendos kufijtë.</li> </ul> |
|--|---|--|

|   |   |   |  |  |  |
|---|---|---|--|--|--|
| Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore  | ◆ | Vendosmëria, marrja e vendimeve gjyqësore | – Merr vendime në bazë të të dhënave të disponueshme;  |  |  |
|   |   |   | – Vepron me vendosmëri edhe kur rritet presioni;   |  |  |
|   |   |   | – I jep një kuptim të qartë dhe të plotë strukturës së vendimmarrjes dhe procesit të ndjekur në hartimin e deklaratës; |  |  |
|   |   |   | – Merr pëlqimin e palëve për vendimin;   |  |  |
|   |   |   | – I jep kuptim të plotë tekstit të formuluar;  |  |  |
|   |   |   | – Percepton mundësitë për të sjellë palët së bashku dhe për të ndërmjetësuar në zgjidhjen e kontestit;                 |  |  |
|   |   |   | – Proceson dhe zgjidh një shumëllojshmëri të të dhënave;   |  |  |
|   |   |   | ◆  | Bindja                                       | – Në mënyrë sistematike shqyrton dhe vlerëson;   |
|   |   |   |  |  | – Bën pyetje në bazë të të kuptuarit;  |
|   |   |   | ◆  | Aftësia analitike dhe aftësia për të gjykuar | – Diskuton çështje sipas situatave;  |
|   |   |   |  |  | – Përdor mendime logjike që çojnë në krijimin e deklaratave deri në arsyetim të qartë dhe transparent; |
|   |   |   | ◆  | Përgjegjësia për udhëheqje                   | – Planifikon dhe organizon punën e vet për rastin;   |
|   |   |   |  |  | – Përfshinë të tjerët në tema të rëndësishme;  |
|   |   |   | ◆  | Udhëheqja                                    | – Lejon aty ku është e mundur të tjerët të shtojnë ekspertizën e tyre;                                 |
|   |   |   |  |  | – Organizon punën e punonjësve në mënyrë sa më efektive që është e mundur;                             |
|   |   |   |  |  | – Informon të tjerët në lidhje me ecurinë e punës;   |
| – Rregullon procedurat (përmbajtja, cilësia dhe përkohshmëria) nëse kërkohet. |   |   |  |  |  |

|                                |   |   |
|--------------------------------|---|---|
| <p>Përkushtimi profesional</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>◆ Aftësia për menaxhimin e zyrës</li> <li>◆ Aftësia për të mësuar dhe vetë-reflektuar</li> <li>◆ Aftësia për të bashkëpunuar</li> <li>◆ Fleksibiliteti dhe aftësia për t'u marrë me ngarkesë të punës</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillon kapacitetet organizative dhe drejtuese, për të kryesuar seancat e marrjes në pyetje dhe për të udhëhequr takime;</li> <li>- Është i hapur për reagime nga të tjerët dhe i përkushtuar ndaj të mësuarit;</li> <li>- Është kurioz, në mënyrë aktive kërkon risi dhe/apo situata të tjera;</li> <li>- I gatshëm për të marrë pjesë në arsimin profesional dhe i angazhuar në trajnime të rregullta, për të rritur kapacitetet profesionale për legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar;</li> <li>- Është i hapur për bashkëpunim me të tjerët;</li> <li>- Merr iniciativë dhe shfrytëzon mundësinë për të ndarë njohuritë, mbështet dhe konsultohet me të tjerët për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e drejtësisë;</li> <li>- Shkëmben praktikatat me institucione të lidhura me punën e gjykatave dhe prokurorive;</li> </ul> |
|--------------------------------|---|---|

|                                    |   |   |
|------------------------------------|---|---|
| <p>Ndërgjegjësi-<br/>mi social</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>◆ Dëgjimi dhe komunikimi</li> <li>◆ Përshtatshmëria</li> <li>◆ Bindja</li> <li>◆ Ndërgjegjësimi për mjedisin shoqëror</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tregon mirëkuptim për situatën e të tjerëve dhe kontakton personalisht dhe ka ndjeshmëri për motivim - të dëgjuarit aktiv - jep ndjesinë për të tjerët që kontributi i tyre është pranuar;</li> <li>- Përshtat qasjen e vet, kur situata ndryshon apo kur ajo dikton, përshtatet në rrethana të veçanta dhe situata të ndryshme;</li> <li>- I jep një kuptim të qartë dhe të plotë strukturës së vendimmarrjes dhe procesit të ndjekur në hartimin e deklaratës;</li> <li>- I jep kuptim të plotë tekstit të formuluar;</li> <li>- Percepton mundësitë për të sjellë palët së bashku dhe për të ndërmjetësuar në zgjidhjen e kontestit;</li> <li>- Ka prirje për zhvillimet sociale dhe formon imazhin e vet në kuadër të ligjit;</li> <li>- Kërkon informacione të vjetra, të reja dhe kontradiktore, perspektiva të ndryshme që mund të ndikojnë në vendim dhe procedurë;</li> <li>- Tregon vetëdije për ndikimin e rrethave të ndryshme dhe të palëve;</li> <li>- Vlerëson ndikimin e rolit dhe pozitës së tyre në kontekstin social, merr parasysh këtë duke ruajtur distancën;</li> <li>- Ka njohuri në lidhje me kontekstin socio-ekonomik, në të cilën janë praktikuar funksionet.</li> </ul> |
|------------------------------------|---|---|

PTF është konceptualizuar dhe vënë në kornizë si program kualifikues profesional, i bazuar në kompetenca, i modularizuar dhe i orientuar në vend pune, i cili integron elemente mësimore teorike dhe praktike. Është i disenjuar veçanërisht për zhvillimin profesional fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Është kombinim prej fazave praktike dhe teorike si dhe atyre udhëzuese dhe vetë-mësimore, duke përfshirë edhe elemente të e-learning.

### 5.3 Përmbajtja e PTF

Përmbajtja e PTF-së reflekton zhvillimin e kompetencave të pjesëmarrësve, e cila do fokusohet në zhvillimin e shkathtësive praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapoemëruar pasi që vlerësohet se përfituesit posedojnë njohuri teorike relevante për funksionin e gjyqtarit.

Përmbajtja e trajnimit fillestar do të fokusohet në zhvillimin e kompetencave profesionale, vlerat etike dhe ndërdisiplinare të gjyqtarëve të sapoemëruar me theks të veçantë tek:

- ◆ Ngritja e kapaciteteve profesionale për legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar;
- ◆ Hartimi i vendimeve gjyqësore bazuar në analizë të fakteve;
- ◆ Aplikimi i rregullave etike;
- ◆ Përshtatja me rrethana dhe situata specifike gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit/prokurorit;
- ◆ Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore;
- ◆ Zhvillimi i shkathtësive sociale;
- ◆ Shkëmbimi i praktikave me institucionet e ndërlidhura me punën e gjykatave dhe prokurorive;
- ◆ Zhvillimi i kapaciteteve hulumtuese, organizative dhe menaxhuese;
- ◆ Zhvillimi i shkathtësive ndërdisiplinare.

Këto kompetenca do të zhvillohen përmes moduleve të cilat janë bashkangjitur si aneks i këtij programi, trajnimit praktik, programeve në institucione jo gjyqësore të ndërlidhur me punën e gjykatave dhe prokurorive si dhe punës praktike që i caktohen nga trajnuesit apo mentorët.

### 5.3.1 Pjesa e trajnimit teorik

Në këtë pjesë trajnimi zhvillohet në mënyrë teorike i kombinuar me raste nga praktika gjyqësore, bazuar në module trajnuese ku përfshihen trajnime nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive vendore, Acquis Communautaire, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe akte të tjera ndërkombëtare.

Sasia e orëve të punës së programuar për secilin nga modulet të cilët do të realizohen përmes kombinimit me trajnimin praktik, përcaktohet në funksion të:

- ◆ Përmbajtjes së modulit trajnues;
- ◆ Natyrës dhe vështirësisë së modulit;
- ◆ Lloji i modulit dhe rëndësia e tij për praktikën gjyqësore/prokuroriale;

Në përgjithësi programi trajnues i secilit modul përmban të paktën një numër të caktuar të sesioneve trajnuese i realizuar sipas planit të punës.

Në kuadër të programit trajnues përveç moduleve profesionale dhe të karakterit interdisiplinar përfshihen edhe modulet shtesë të cilat do të realizohen nëpërmjet platformës së mësimin në distancë.

### 5.3.2 Pjesa e trajnimit praktik

Pjesa e trajnimit praktik zhvillohet në gjykata. Trajnimi realizohet nën mbikëqyrjen e mentorit (gjyqtarë), i cili është mbikëqyrës për zbatimin e programit trajnues siç është përcaktuar në këtë program dhe doracakun e trajnimit praktik, si dhe për të bërë vlerësimin e performancës së përfituesit gjatë trajnimit. Programi praktik përfshinë çështje nga aspekti profesional, rregullat e komunikimit, menaxhimin e rasteve, etikën dhe çështje tjera të karakterit praktik me interes për përfituesin. Gjatë këtij trajnimi, Gjyqtari i sapoemëruar mund t'i asistoj gjyqtarit gjatë ushtrimit të funksionit të tij, merr pjesë në aktivitete gjyqësore me rastin e praktikës së tij/saj, por gjithmonë nën udhëheqjen e mentorit.

Programi i trajnimit praktik realizohet mbështetur në “Doracakun për Trajnimin Praktik” i cili përmban programin trajnues që duhet ndjekur gjyqtarët e sapoemëruar dhe specifikon detyrat dhe përgjegjësitë e mentorëve dhe përfituesve gjatë realizimit të trajnimit praktik. Doracaku është pjesë e këtij programi trajnues.

Qëllimi i këtij doracaku është që të përshkruajë rolin dhe përgjegjësitë e mentorëve dhe përfituesve gjatë trajnimit praktik të PTF-së (fazës së mentorimit). Doracaku gjithashtu përshkruan disa nga kompetencat ligjore, etike dhe interdisiplinare që pjesëmarrësit në programin e praktikës duhet t'i përfitojnë gjatë trajnimit praktik.



Mentorëve u janë dhënë edhe ide rreth asaj se si t'i ekspozojnë përfituesit ndaj një game të gjerë të temave që do t'i përgatiste ata të marrin detyrat e tyre zyrtare, pas përfundimit të trajnimit fillestar. Fokusi i doracakut dhe programit të praktikës është që të theksojë rëndësinë e ofrimit të përvojës reale praktike për përfituesit në zhvillimin e aftësive të tyre, duke filluar nga ato profesionale, shkrimi ligjor, të menduarit kritik, etika, rregullat e komunikimit, menaxhimi i rasteve dhe shumë të tjera të karakterit praktik me interes për përfituesit.

Po ashtu, gjatë trajnimit praktik, gjyqtarët e sapoemëruar do të ndjekin një modul të veçantë trajnues i cili realizohet krahas trajnimit praktik. Ky modul ka të bëjë me ngritjen e shkath-

tësive gjyqësore të përfituesve bazuar në ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale lidhur me marrjen në pyetje dhe udhëheqjen e shqyrtimit gjyqësor. Në mënyrë specifike ngritja e shkathtësive do bëhet për fjalën hyrëse, marrjen e drejtpërdrejtë dhe të tërthorët në pyetje, vënien në dyshim, rehabilitimin dhe fjalën përfundimtare.

Gjatë kësaj pjese të trajnimit pjesëmarrësit mund të ndjekin edhe trajnime në platformën e mësimi në distancë dhe programe të ndryshme praktike në institucionet jo gjyqësore. Në përfundim të këtij trajnimi, mentorët bëjnë një vlerësim për përfituesit ku përfshihet, performanca e tyre e përgjithshme gjatë trajnimit, aspekti i punës praktike profesionale, respektimi i orarit, etj.

## 5.4 Program trajnimi në institucionet jo gjyqësore

Krahas trajnimit praktik nëpër gjykata, gjyqtarët e sapoemëruar do të ndjekin edhe trajnime në institucione të ndryshme të sistemit të drejtësisë dhe jashtë tyre puna e të cilave është e ndërlidhur me punën e tyre. Kjo do të mundësohet me bashkëpunimin e krijuar në mes të IGJK-së dhe këtyre institucioneve.

Institucionet në të cilat gjyqtarët e sapoemëruar do të ndjekin trajnime, janë:

- Gjykata Kushtetuese
- Oda e Avokatëve
- Avokati i Popullit
- Policia e Kosovës
- Shërbimi Korrektues
- Shërbimi Sprovues
- Qendra për Punë Sociale
- Agjensioni Kundër Korrupsion
- Dogana e Kosovës
- Komisioni i Ndërmjetësimit
- Agjencioni i Privatizimit
- Agjencia Kadastrale e Kosovës
- Agjencia Kosovare e Pronës
- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës
- Zyra e Auditorit Gjeneral
- Administrata Tatimore e Kosovës
- Agjencioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- Instituti i Mjekësisë Ligjore

## 5.5 Simulimet e gjykimeve

Përveç metodave të trajnimit tradicional si diskutime interaktive, studimeve të rasteve praktike, përfituesit e trajnimit fillestar gjatë trajnimit do të përfshihen edhe në simulime të gjykimeve.

Simulimi i gjykimeve realizohet përmes përzgjedhjes së rasteve nga praktika gjyqësore nga lëmia penale/civile me përfshirje të elementeve edhe nga fusha tjera të së drejtës.

Qëllimi i simulimit të gjykimit është ngritja e aftësive dhe shkathtësive në të shprehur, rritja e vetëbesimit, zhvillimi i mendimit kritik si dhe aftësia për të punuar në ekip. Gjithashtu përmes simulimit të gjykimit pjesëmarrësit mund të përmirësojnë mënyrën e analizimit dhe arsyetimit të fakteve, zhvillojnë shkathtësinë për të dëgjuar dhe bashkëpunuar, të kuptojnë më mirë sistemin gjyqësor, si dhe të avancojnë njohjen e rregullave të të provuarit para trupit gjykues.

## 5.6 Puna hulumtuese

Në kuadër të kompetencave të trajnimit fillestar përfshihet edhe puna hulumtuese, ku kjo kompetencë realizohet qoftë përmes rasteve praktike gjatë trajnimit si dhe punimeve në revistën juridike “Justicia”. Revista përmban tema të ndryshme që trajtojnë institute të ndryshme të së drejtës, aspekte të ndryshme nga legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar.

Qëllimi i kësaj reviste juridike përveç formimit dhe ngritjes së shkathtësive të përfituesve në sferën e hulumtimit dhe shkrimit ligjor është edhe ofrimi i mbështetjes profesionale për juristët e rinj, gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor.



## 6 Vlerësimi

Procesi i vlerësimit të përfundimit të suksesshëm të programit trajnues nga gjyqtarët e sapoemëruar përcaktohet me Rregulloren për Programin e Trajnimit Fillestar e miratuar nga Këshilli Drejtues i IGJK-së. Ky proces realizohet por nuk kufizohet vetëm, përmes raportit për vijueshmërinë në trajnim, raportit të trajnuesve, raportit të mentorëve, dhe vlerësimit për punimet hulumtuese të cilat përmbledhen në një raport përfundimtarë të përgatitur nga IGJK, i cili dërgohet në KGJK-së dhe KPK-së në fund të programit trajnues.

Testimet e pjesëmarrësve mund të bëhen sipas këtij sistemi:

- Testimi përfundimtar për PTF përbëhet nga rezultatet e secilit test modular;
- Testimet në module mund të zbatohen në forma të ndryshme: teste me shkrim, teste verbale, elaborime me shkrim, prezantime;
- Parakusht për pjesëmarrje në test modular është pjesëmarrja e rregullt në trajnim dhe përmbushja autonome e kërkesave të PTF-së gjatë seancave për trajnim;

Vlerësimi gjatë trajnimit teorik do të bëhet bazuar në skemën e lartshënuar që kanë të bëjnë me zhvillimin e kompetencave tek pjesëmarrësit e trajnimeve bazuar në skemën e mëposhtme, ndërsa i gjithë procesi i vlerësimit të rezultateve të trajnimit do të bazohet në kriteret e përcaktuara me ligj dhe aktet tjera normative për vlerësimin e gjyqtarëve.



## 6.1 Shembull i vlerësimit nga ana e trajnuesit

Formular për vlerësim nga ana e trajnuesit për punën praktike apo rastet praktike të pjesëmarrësve në trajnim, përveç vlerësimeve në provime.

| Emri dhe mbiemri i gjyqtarit/prokurorit të shtetit në PTF: |  | Moduli Trajnues:                       |  |  |  |
|--|--|--|--|--|--|
| Identifikim i Fakteve                                      | Njohja dhe zbatimi i ligjit            | Analizimi i fakteve                    | Konkluzioni dhe arsyetimi              | Gjuha e përdorur                       | Vlerësimi i përgjithshëm               |
| <input type="checkbox"/> Pamjaftueshëm                     | <input type="checkbox"/> Pamjaftueshëm | <input type="checkbox"/> Pamjaftueshëm | <input type="checkbox"/> Pamjaftueshëm | <input type="checkbox"/> Pamjaftueshëm | <input type="checkbox"/> Pamjaftueshëm |
| <input type="checkbox"/> Mjaftueshëm                       | <input type="checkbox"/> Mjaftueshëm   | <input type="checkbox"/> Mjaftueshëm   | <input type="checkbox"/> Mjaftueshëm   | <input type="checkbox"/> Mjaftueshëm   | <input type="checkbox"/> Mjaftueshëm   |
| <input type="checkbox"/> Mirë                              | <input type="checkbox"/> Mirë          | <input type="checkbox"/> Mirë          | <input type="checkbox"/> Mirë          | <input type="checkbox"/> Mirë          | <input type="checkbox"/> Mirë          |
| <input type="checkbox"/> Shumë mirë                        | <input type="checkbox"/> Shumë mirë    | <input type="checkbox"/> Shumë mirë    | <input type="checkbox"/> Shumë mirë    | <input type="checkbox"/> Shumë mirë    | <input type="checkbox"/> Shumë mirë    |

Komenti i trajnuesit dhe rekomandimi për fusha(t) ku pjesëmarrësi ka nevojë për përmirësim dhe zhvillim të kompetencës/ ku nevojiten trajnime, nëse është e zbatueshme:

Data: \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

Emri & Nënshkrimi i Trajnuesit \_\_\_\_\_

## 6.2 Shembull i tabelës së vlerësimit nga ana e Mentorit

|   | Niveli       |                          |
|---|--------------|--------------------------|
| Aftësia për t'i identifikuar dhe përdorur rregullat e deontologjisë<br>(Kompetenca <b>“Integriteti personal dhe sjellja profesionale”</b> )               | E arritur    | <input type="checkbox"/> |
|   | Në progres   | <input type="checkbox"/> |
|   | E pa arritur | <input type="checkbox"/> |
| Aftësia për të analizuar dhe përshkruar një situatë apo rast<br>(Kompetenca <b>“Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore”</b> )                                 | E arritur    | <input type="checkbox"/> |
|   | Në progres   | <input type="checkbox"/> |
|   | E pa arritur | <input type="checkbox"/> |
| Aftësia për ti identifikuar, respektuar dhe garantuar rregullat ligjore (Kompetenca <b>“Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore”</b> )                         | E arritur    | <input type="checkbox"/> |
|   | Në progres   | <input type="checkbox"/> |
|   | E pa arritur | <input type="checkbox"/> |
| Aftësia për përshtatje dhe adaptim<br>(Kompetenca <b>“Ndërgjegjësimi social”</b> )  | E arritur    | <input type="checkbox"/> |
|   | Në progres   | <input type="checkbox"/> |
|   | E pa arritur | <input type="checkbox"/> |
| Aftësia për tu adaptuar dhe për të treguar autoritet në rrethana dhe situata specifike<br>(Kompetenca <b>“Ndërgjegjësimi social”</b> )                    | E arritur    | <input type="checkbox"/> |
|   | Në progres   | <input type="checkbox"/> |
|   | E pa arritur | <input type="checkbox"/> |
| Aftësia për të pasur marrëdhënie të mirëfillta, dëgjim aktiv dhe shkëmbim informatash<br>(Kompetenca <b>“Ndërgjegjësimi social”</b> )                     | E arritur    | <input type="checkbox"/> |
|   | Në progres   | <input type="checkbox"/> |
|   | E pa arritur | <input type="checkbox"/> |
| Aftësia për të monitoruar një audiencë në gjykatë, mirëpo me respekt ndaj palës kundërshtare<br>(Kompetenca <b>“Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore”</b> ) | E arritur    | <input type="checkbox"/> |
|   | Në progres   | <input type="checkbox"/> |
|   | E pa arritur | <input type="checkbox"/> |
| Aftësia për të gjetur zgjidhje dhe pajtuar palët<br>(Kompetenca <b>“Integriteti profesional dhe sjellja profesionale”</b> )                               | E arritur    | <input type="checkbox"/> |
|   | Në progres   | <input type="checkbox"/> |
|   | E pa arritur | <input type="checkbox"/> |
| Aftësia për të marrë vendime të bazuara në drejtësi dhe fakte<br>(Kompetenca <b>“Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore”</b> )                                | E arritur    | <input type="checkbox"/> |
|   | Në progres   | <input type="checkbox"/> |
|   | E pa arritur | <input type="checkbox"/> |
| Aftësia për motivim, formalizëm dhe shpjegim të vendimeve<br>(Kompetenca <b>“Ndërgjegjësimi social”</b> )   | E arritur    | <input type="checkbox"/> |
|   | Në progres   | <input type="checkbox"/> |
|   | E pa arritur | <input type="checkbox"/> |
| Aftësia për të pasur parasysh rrethanat institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare<br>(Kompetenca <b>“Ndërgjegjësimi social”</b> )                        | E arritur    | <input type="checkbox"/> |
|   | Në progres   | <input type="checkbox"/> |
|   | E pa arritur | <input type="checkbox"/> |
| Aftësia për të punuar në grup<br>(Kompetenca <b>“Angazhimi profesional”</b> )   | E arritur    | <input type="checkbox"/> |
|   | Në progres   | <input type="checkbox"/> |
|   | E pa arritur | <input type="checkbox"/> |
| Aftësia për organizimin, menaxhimin dhe marrjen e iniciativave.<br>(Kompetenca <b>“Angazhimi profesional”</b> )   | E arritur    | <input type="checkbox"/> |
|   | Në progres   | <input type="checkbox"/> |
|   | E pa arritur | <input type="checkbox"/> |

## 7. Kalendari dhe orari trajnues

Për realizimin e këtij programi do të hartohet kalendari i aktiviteteve trajnuese. Trajnimi fillestar mbahet 5 ditë në javë. Pjesa e trajnimit teorik mbahet në IGJK, ndërsa trajnimi praktik në gjykata dhe i shoqëruar me trajnimet në institucionet tjera jo gjyqësore.

Trajnimi teorik dhe praktik do të realizohen në mënyrë të kombinuar sipas modelit 2 ditë trajnimi teorik në IGJK dhe 3 ditë trajnimi praktikë në gjykata. Ky orar do të jetë fleksibil me qëllim të përmbushjes së programit të trajnimit teorik siç është përcaktuar në secilin modul trajnimi.

Orari i trajnimeve dhe numri i sesioneve trajnuese është përcaktuar në konsultim të ngushtë edhe me të gjithë akterët relevant.

Kushtet e pjesëmarrjes në trajnim dhe mungesave gjatë trajnimit janë të rregulluara me Rregulloren për Trajnimin Fillestar.



## 8. Modulet trajnuese të PTF 2017/2018 për gjyqtarët e sapoemëruar

Modulet e trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar si dhe sesionet për secilin modul janë si më poshtë:

| Modulet Trajnuese |  |              |   |                |
|-------------------|--|--------------|---|----------------|
| Nr.               | Emërtimi i modulit                               | Orë trajnimi | Nënmoduli / nënpjesa  | Nr i sesioneve |
| 1.                | Rendi juridik kombëtarë dhe ndërkombëtarë        | 60 orë       | 1.1 E Drejta Kushtetuese  | 1              |
|                   |  |              | 1.2 Organizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial                  | 2              |
|                   |  |              | 1.3 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile  | 2              |
|                   |  |              | 1.4 E drejta e BE-së  | 5              |
|                   |  |              | 1.5 Legjislacioni për të Drejtat e Njeriut - KEDNJ                  | 10             |
| 2.                | Kodi Penal i Republikës së Kosovës               | 78 orë       | 2.1 Kodi Penal i Kosovës – pjesa e përgjithshme                     | 10             |
|                   |  |              | 2.2 Kodi Penal i Kosovës – pjesa e veçantë                          | 10             |
|                   |  |              | 2.3 Veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare | 2              |
|                   |  |              | 2.4 Krimet e rënda  | 1              |
|                   |  |              | 2.5 Parashkrimi   | 3              |
| 3.                | Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës | 153 orë      | 3.1 Ekspertiza dhe analizat   | 4              |
|                   |  |              | 3.2 Kontrolli dhe konfiskimi  | 5              |
|                   |  |              | 3.3 Masat e Fshehta të Hetimit dhe të Vëzhgimit                     | 4              |
|                   |  |              | 3.4 Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë     | 5              |
|                   |  |              | 3.5 I pandehuri në procedurën penale                                | 5              |
|                   |  |              | 3.6 Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale               | 5              |
|                   |  |              | 3.7 Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë                 | 3              |
|                   |  |              | 3.8 Administrimi i procedurës penale                                | 2              |
|                   |  |              | 3.9 Shqyrtimi fillestar i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor               | 6              |
|                   |  |              | 3.10 Marrja dhe komunikimi i vendimeve dhe dërgimi i shkresave      | 1              |
|                   |  |              | 3.11 Shpenzimet e procedurës dhe kërkesat pasurore juridike         | 1              |
|                   |  |              | 3.12 Procedura sipas mjeteve juridike                               | 2              |
|                   |  |              | 3.13 Procedurat e veçanta sipas KPPK                                | 2              |
|                   |  |              | 3.14 Provat në procedurën penale                                    | 6              |

| Modulet Trajnuese |   |  |  |                |
|-------------------|---|--|--|----------------|
| Nr.               | Emërtimi i modulit                            | Orë Trajnimi                           | Nënmoduli / nënpjesa   | Nr i sesioneve |
| 4.                | E drejta civile, administrative dhe ekonomike | 237 orë                                | 4.1 E drejta civile  | 6              |
|                   |   |  | 4.2 Procedura Kontestimore-pjesa e parë                      | 10             |
|                   |   |  | 4.3 Procedura Kontestimore-pjesa e dytë                      | 10             |
|                   |   |  | 4.4 Procedura Jokontestimore                                 | 3              |
|                   |   |  | 4.5 Procedura Përmbarimore                                   | 4              |
|                   |   |  | 4.6 E drejta Administrative                                  | 5              |
|                   |   |  | 4.7 E drejta e Detyrimeve                                    | 10             |
|                   |   |  | 4.8 E drejta Ekonomike                                       | 5              |
|                   |   |  | 4.9 E drejta e Pronësisë dhe të drejtat e tjera të përafërta | 10             |
|                   |   |  | 4.10 E drejta e Trashëgimisë                                 | 2              |
|                   |   |  | 4.11 E drejta e Punës  | 3              |
|                   |   |  | 4.12 E drejta Familjare                                      | 6              |
|                   |   |  | 4.13 Marrja dhe administrimi i provave në procedurën civile  | 5              |
| 5.                | Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare    | 90 orë                                 | 5.1 Rregullat e Komunikimit                                  | 2              |
|                   |   |  | 5.2 Etikë profesionale                                       | 10             |
|                   |   |  | 5.3 Menaxhimi i rasteve                                      | 3              |
|                   |   |  | 5.4 Ngritja e shkathtësive sociale të gjyqtarëve             | 3              |
|                   |   |  | 5.5 Arsyetimi i vendimeve gjyqësore                          | 10             |
|                   |   |  | 5.6 Menaxhimi i stresit                                      | 2              |
| 6.                | Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese     | 24 orë+ 6/12 ditë trajnimi (2/4 grupe) | 6.1 Kodi i Drejtësisë për të Mitur                           | 3              |
|                   |   |  | 6.2 Ndërmjetësimi  | 2              |
|                   |   |  | 6.3 Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore                       |                |
|                   |   |  | 6.4 Ligji për kundërvajtje                                   | 3              |
| 7.                | Mësimi në distancë                            |  | 7.1 Gjuhë angleze  |                |
|                   |   |  | 7.2 Teknologjia informative                                  |                |
|                   |   |  | 7.3 Menaxhimi i stresit                                      |                |



## 9. Modulet trajnuese PTF 2017 - 2018

### 9.1 Rendi juridik kombëtarë dhe ndërkombëtarë

#### 9.1.1 E drejta Kushtetuese

Në këtë modul pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të njoftohen lidhur me burimet kushtetuese në Republikën e Kosovës, kuadrin normativ mbi Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, përbërjen e gjykatës, kompetencat e saja, procesin e kontrollit kushtetues dhe me vendimet e Gjykatës Kushtetuese si dhe efektet e tyre.

Kompetencat e synuara për zhvillim në këtë modul janë:

- Të qenurit të bindur lidhur me demokracinë dhe sundimin e ligjit si vlerat më të larta dhe parimet udhëheqëse të shtetit të Kosovës dhe aftësia për t'i përfaqësuar ato në punë si gjyqtarë;
- Të kuptuarit e kushtetutës si norma më e lartë në sistemin kombëtar ligjor dhe të qenurit të vetëdijshëm mbi ndikimin e ligjit ndërkombëtar në sistemin kombëtar ligjor;
- Të qenurit të vetëdijshëm mbi ndikimin e të drejtave fundamentale në shtetin dhe sistemin gjyqësor dhe aplikimi i tyre në punën praktike si gjyqtarë;
- Të qenurit jashtëzakonisht mirë të informuar lidhur me sistemin gjyqësor, organet e tij, strukturën e punës dhe statusin, detyrat e gjyqtarëve dhe të jenë në gjendje për të zbatuar gjithë këtë në punën e tyre;
- Të qenurit jashtëzakonisht mirë të informuar për gjykatën kushtetuese, strukturën e saj të punës dhe procedurat dhe efektet ligjore të vendimeve të saj, sidomos për gjykatat e shkallëve më të ulëta;

**Kohëzgjatja:** 1 sesion trajnimi (3 orë trajnimi)

### 9.1.2 Organizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial

Moduli do të përmbaj njohuritë themelore për të kuptuar se si duket struktura e organizimit të sistemit gjyqësor të Kosovës, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatat dhe Prokurorin e Shtetit, çfarë janë kompetencat e gjykatave dhe prokurorive dhe si është bërë shtrirja e re territoriale e tyre.

Me fillimin e zbatimit të ligjeve është bërë reformimi i tërësishëm i sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës, duke e braktisur sistemin e vjetër të organizimit të gjykatave dhe prokurorive me kompetenca të përziera e herëherë të pa definuara qartë dhe duke

ndërtuar një sistem të ri të organizimit të gjykatave dhe prokurorive që bazohet në ndarjen e plotë të kompetencave në mes të instancave të ndryshme gjyqësore i cili ka parashikuar se në linjë vertikale ky sistem është konstituar në tri nivele gjyqësore.

Sistemi i ri gjyqësor ka edhe organizim tjetër territorial nga ai që kishte me parë dhe ky organizim i ri paraqet segmentin tjetër të reformës gjyqësore, që synon racionalizimin e sistemit gjyqësor, bërjen e tij më efikas dhe lehtësimin e qasjes në gjyqësor për qytetarët e vendit.

**Kohëzgjatja:** 2 sesione trajnimi (6 orë trajnimi)

### 9.1.3 Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile

Kriminaliteti i pothuaj se të gjitha profileve e në veçanti krimi i organizuar, gjithnjë e më shumë është duke u ndërkombëtarizuar. Për shkak të rrethanave në të cilat sot gjendet shoqëria njerëzore, sidomos për shkak të zgjerimit të mundësive që kanë kryerësit e veprave penale për tejkalimin e kufijve, gjyqtarët dhe prokurorët duhet të njihen me praktikat efikase të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile.

Gjatë prezantimit të këtij moduli do të paraqiten njohuritë themelore për të kuptuar se çka është bashkëpunimi juridik ndërkombëtar si dhe roli dhe rëndësia e tij në çështjet penale dhe civile.

Përfituesit gjatë pjesës së ushtrimeve do të shohin shembuj të formave nga praktika kur kërkohet bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale apo ato civile.

**Kohëzgjatja:** 2 sesione trajnimi (6 orë trajnimi)

### 9.1.4 E Drejta e Bashkimit Evropian

Edhe pse Kosova ende nuk është anëtare e Bashkimit Evropian, njohja e institucioneve dhe e të së drejtës së Bashkimit Evropian është më se e rëndësishme për proceset e ardhshme të integritimit të saj, që në pjesë të mëdha është reformë juridike drejtuar harmonizimit të së drejtës së Kosovës me të ashtuquajturin *acquis communautaire*, e që mund të përkthehet me “të arriturat e përbashkëta”, apo me fjalë të tjera me standardet politike dhe juridike evropiane. Përveç kësaj, e drejta evropiane është tejet interesante dhe sfiduese në aspektin intelektual, sepse gërsheton në vete shumë disiplina juridike, përfshirë të drejtën ndërkombëtare publike, të drejtën kushtetuese, të drejtën administrative dhe të drejtën ekonomike.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së hyri në fuqi në prill të vitit 2016. Kjo kontratë e parë e detyrueshme ndërkombëtare ndërmjet të dyja palëve parasheh harmonizim të pjesshëm ligjor në përputhje me *Acquis-in* dhe prezantimin e pjesshëm të katër lirive të tregut brenda pesë viteve të ardhshme. Kjo kërkon njohuri dhe shkathtësi adekuate ligjore të gjyqësorit.

Në këtë drejtim përveç njohjes me këtë lëmi gjatë studimeve themelore apo edhe atyre të specializuar njëkohësisht është domosdoshmëri që gradualisht edhe gjyqësori i Republikës së Kosovës të filloj ti ngritë njohurit e veta lidhur me të drejtën e Bashkimit Evropian.

**Kohëzgjatja:** 5 sesione trajnimi (15 orë trajnimi)

### 9.1.5 Legjislacioni për të drejtat e njeriut - KEDNJ

Të drejtat e njeriut janë themel i ekzistencës dhe bashkë-ekzistencës njerëzore. Ato janë universale, të pandashme dhe të ndërvarura. Ato gjenden në thelb të çdo qëllimi që Kombet e Bashkuara pretendojnë të arrijnë në misionin e tyre global të paqes dhe zhvillimit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut me seli në Strasburg, e themeluar në bazë të Konventës Evropiane, me seriozitetin dhe përkushtimin e gjyqtarëve të saj, është shndërruar sot në një institucion të rëndësishëm dhe prestigjioz për standardizimin e sistemeve juridike të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës në fushën e të drejtave të njeriut.

Vendimet e gjykatës, të cilat janë përgjithësisht të shënuara nga racionaliteti dhe emancipimi, kanë autoritet të veçantë edhe për vendet me demokraci të zhvilluar, të cilat ndeshen me shumëllojshmërinë e sfidave dhe të dilemave që mbart qytetërimi i sotëm. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është arritja më e madhe e Këshillit të Evropës. E njëjta jo vetëm që ka formuluar katalogun e të drejtave të njeriut, por edhe ka siguruar sistemin e kontrollit për zbatimin e saj.

Përmes këtyre moduleve synohet që pjesëmarrësit të zgjerojnë njohuritë për standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe në anën tjetër përmbajtja e moduleve do të jenë burim i vlefshëm për të gjithë ata që janë përfshirë në avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që janë pjesë e sistemit gjyqësor në Kosovë.

**Kohëzgjatja:** 10 sesione trajnimi (30 orë trajnimi)

## 9.2 Kodi Penal i Republikës së Kosovës

### 9.2.1 Kodi Penal – Pjesa e përgjithshme

Vepra penale është vepër e njeriut e cila është e kundërligjshme, e kryer me faj dhe e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, por e cila njëherit është edhe vepër e rrezikshme.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë përcaktuar me ligj dhe për të cilën me ligj është i paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.

Pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të njoftohen për veprën penale duke përfshirë elementet themelore të veprës penale si dhe figurën e veprës penale.

Gjithashtu ata do të njoftohen se cilat vepra penale kryhen me dashje dhe rastet kur kryhen nga pakujdesia. Po ashtu pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të njoftohen me ngjashmëritë dhe dallimet e veprave penale, të të njëjtit kapitull dhe kapitujve tjerë.

**Kohëzgjatja:** 10 sesione trajnimi (30 orë trajnimi)

### 9.2.2 Kodi Penal – Pjesa e veçantë

Duke pasur parasysh vëllimin e veprave penale që përmban pjesa e veçantë e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, gjatë trajnimit do të synohet që pjesëmarrësit të njoftohen, me veprat penale më karakteristike dhe që sot në Republikën e Kosovës, janë më aktuale në punën e prokurorive dhe të gjykatave.

Pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të njoftohen me disa vepra penale të çdo kapitulli veç e veç, elementet e veprave penale si dhe kush mund të jetë kryes i veprave penale. Gjithashtu do të njoftohen se cilat vepra penale kryhen me dashje dhe rastet kur kryhen nga pakujdesia.

**Kohëzgjatja:** 10 sesione trajnimi (30 orë trajnimi)

### 9.2.3 Veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare

Korrupsioni është fenomen i vjetër, i cili gjithmonë ka paraqitur problem serioz për shoqërinë. Gjatë historisë, vende të shumta janë përpjekur për gjetjen e mënyrave për të luftuar këtë dukuri të rrezikshme. Me problemin e korrupsionit sot janë të ballafaquar pothuajse të gjitha vendet e botës. Edhe pse, ende nuk ekziston një definicion unik për korrupsionin, shumë shtete të botës kanë përcaktuar në legjislacionet e tyre veprat penale të korrupsionit. Nga pikëpamja ligjore, korrupsioni nuk paraqet një vepër penale të vetme por një grup të përgjithshëm të veprave

specifike penale. Nga kjo del se përkufizimi ligjor i korrupsionit, mund të definohet si grup i veprave të ndryshme penale të përfshira në një kapitull nën titullin e përbashkët “korrupsioni”. Grupimi i veprave penale të korrupsionit është esencial për t’i identifikuar veprat e ndryshme që bien nën klasifikimin e përgjithshëm të korrupsionit.

Pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të njoftohen me veprat penale të korrupsionit veç e veç, elementet e veprave penale si dhe kush mund të jetë kryes i këtyre veprave penale

**Kohëzgjatja:** 2 sesione trajnimi (6 orë trajnimi)

### 9.2.4 Krimet e rënda

Krimet e rënda në përgjithësi dhe trafikimi më qenie njerëzore, shpëlarja e parave dhe krimet kibernetike në veçanti, sot paraqesin një sfidë për të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, ku Kosova synon që të jetë pjesë e saj, andaj trajtimi i këtyre krimeve gjatë zhvillimit të këtij moduli ka një rëndësi të veçantë, nga fakti se parandalimi dhe luftimi më sukses i këtyre krimeve i hap rrugën Kosovës për anëtarësim në BE dhe për një siguri juridike për të gjithë qytetarët e Kosovës.

**Kohëzgjatja:** 1 sesion trajnues (3 orë trajnimi)

### 9.2.5 Parashkrimi

Parashkrimi si institut juridik nënkupton se për shkak të kalimit të afatit ligjor nuk mund të ushtrohet ndjekja penale, nuk mund të shqiptohet dënimi dhe nuk mund të ekzekutohet sanksioni penal, i cili është i ndryshueshëm dhe rrjedh nga lloji i veprës penale, si dhe lartësia e dënimit. Në anën tjetër janë disa vepra penale që asnjëherë nuk i nënshtrohen parashkrimit.

Ky modul do të përmbaj, por nuk do

të kufizohet në çështjet si; fillimi i rrjedhës së afatit të parashkrimit, ndalja dhe ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale, parashkrimi absolut, parashkrimi i ekzekutimit të dënimit përfshirë atë absolut, ndalja dhe ndërprerja e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm, mos parashkrimi i veprave penale të gjenocidit dhe krimeve të luftës.

**Kohëzgjatja:** 3 sesione trajnimi (9 orë trajnimi)

## 9.3 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

### 10.3.1 Ekspertiza dhe analizat

Shumë fakte do të kishin mbetur të pandriçuara në procedurën penale bashkëkohore, po të mos ishte pranuar si provë në procedurë penale edhe ekspertiza. Pranimi dhe përshtatja e saj nevojave të procedurës penale, ka bërë që sot në këtë procedurë të vërtetohen edhe fakte të cilat më parë vetëm kanë mundur të ëndërrohen. Me shfrytëzimin e kësaj prove, në procedurë penale përcillet edhe ritmi i shpejtuar i zhvillimeve të lëmenjve të ndryshëm shkencor, e posaçërisht shfrytëzimi i këtyre të arriturave shkencore për kryerjen e aktivitetit kriminal. Këto janë vetëm disa të dhëna nga të cilat shihet rëndësia e kësaj prove që e ka për procedurën penale bashkëkohore.

Kjo çështje, sikurse edhe shumë të tjera, në literaturën profesionale juridike është shqyrtuar pak, por edhe atëherë kur është folur për të, është folur në mënyrë të përgjithësuar dhe të pamjaf-tueshme.

Pjesëmarrësit do të kenë mundësi që nga ky trajnim të mësojnë për të gjitha çështjet relevante lidhur me ekspertizën dhe momentet kur do të duhej të caktohet eksperti, dhe kur do të duhej të kërkohej analiza e caktuar dhe si dhe për çfarë mundë ta përdorë rezultatin e asaj ekspertize apo analize. Pjesëmarrësit do të mësojnë nga ky trajnim edhe se si këto institute zbatohen në praktikë.

**Kohëzgjatja:** 4 sesione trajnuese (12 orë trajnimi)

### 9.3.2 Kontrolli dhe konfiskimi

Në këtë modul do të trajtohen në mënyrë të përgjithshme dhe të posaçme veprimet procedurale që janë të parapara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, me Kodin e Procedurës Penale, me Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskim, me Ligjin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar, si dhe me dispozitat tjera ligjore për konfiskimin e dobisë pasurore të përfutur me vepër penale ose të pasurisë e cila është përdor për kryerjen e veprës penale.

**Kohëzgjatja:** 5 sesione trajnimi (15 orë trajnimi)



### 9.3.3 Masat e Fshehta të Hetimit dhe të Vëzhgimit

Në kapitullin e XXIX të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës janë përfshirë Masat e Fshehta dhe Teknike të Vëzhgimit dhe Hetimit të cilat nuk kanë histori të gjatë të aplikimit në sistemin penal të Kosovës pasi që si veprime hetimore nuk kanë qenë të parapara me ligjet e mëparshme të procedurës penale mirëpo me zhvillimin teknik dhe shoqëror kanë gjet aplikim sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Sipas Kodit të Procedurës Penale janë paraparë 14 masa të fshehta teknike të vëzhgimit, ashtu që gjyqtari i procedurës paraprake, me kërkesë të prokurorit të shtetit mund të urdhërojë secilën nga këto masa.

Qëllimi i zbatimit të këtyre masave ka qenë dhe është parandalimi i kryerjes së veprave penale, zbulimi më efikas i veprave penale, si dhe ndjekja e kryesve të veprave penale për rastet kur nuk mund që të zbulohen me veprime tjera hetimore.

Këto masa pa dyshim që prekin në privatësinë e jetës së njeriut dhe në liri të drejtat e tij, dhe për ata është edhe i kushtëzuar me ligj lejimi i lëshimit të këtyre masave, mirëpo për hir të parandalimit të kryesve të veprave penale këto masa do të aplikohen kur me masat tjera nuk mund të arrihet një informacion apo zbulimi i kryesit të veprës penale dhe do të tentohet që sa më pak të preket në të drejtat e njeriut.

Qëllimi i këtij moduli është që pjesëmarrësve në rend të parë, t'iu ofrohen njohuri teorike dhe praktike me rastin e aplikimit të dispozitave përkatëse për marrjen e informatave në fazën e hetimeve përkatësisht zbatimin e masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit. Pra, objektiv i trajtimit janë dispozitat ligjore, të cilat e rregullojnë institutin e masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit gjatë procedurës penale në fazën e hetimeve, apo siç quhen sipas KPRK marrja e informatave në fazën e hetimeve.

**Kohëzgjatja: 4 sesione trajnimi (12 orë trajnimi)**

### 9.3.4 Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë

Me qëllim të zbatimit të procedurës gjyqësore konform standardeve më të larta në mbrojtje të drejtave dhe lirive të njeriut sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës është e nevojshme prania e të pandehurit në procedurë penale. Lidhur me këtë Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës ka paraparë një sërë masash për të siguruar prezencën e të pandehurit në procedurë.

Përmes këtij moduli synohet që pjesëmarrësit të mësojnë zbatimin në praktikë të këtyre masave, problemet të cilat paraqiten me rastin e moszbatimit apo zbatimit jo të drejtë të këtyre dispozitave ligjore dhe efektin e tyre në procedurën gjyqësore.

Ky modul është bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të cilat dispozita janë përshtatur për këtë modul dhe të cilat do të shpjegohen duke u dhënë sqarime dhe interpretime bazuar në praktikën gjyqësore.

**Kohëzgjatja:** 5 sesione trajnimi (15 orë trajnimi)

### 93.5 I pandehuri në procedurë penale

Gjatë prezantimit të këtij moduli do të paraqiten njohuritë themelore për të sqaruar se çfarë është kuptimi i shprehjes i pandehur, kur dhe në cilat raste një person mund të trajtohet si i pandehur, cilat janë dallimet e shprehjeve “i dyshuar”, “i pandehur”, “i akuzuar” dhe “i dënuar”. Prezantimi do t’u ofroj mundësi pjesëmarrësve të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e të pandehurit gjatë procedurës penale, nga fillimi deri në përfundim të procedurës.

Pjesëmarrësit do të njoftohen se cilat janë të drejtat e të pandehurit gjatë gjithë fazave të procedurës penale, ku gjendet baza ligjore që garanton të drejtat e të pandehurit, në cilat raste të drejtat e tij mund të kufizohen në bazë të ligjit dhe së fundi cilat janë detyrimet e të pandehurit gjatë procedurës penale.

Po ashtu në kuadër të këtij moduli pjesëmarrësit do të njoftohen se cilat janë organet e autorizuar për zbatimin e procedurës të cilat duhet të kujdesen për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të pandehuri, cilat janë përgjegjësitë e tyre për mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe cilat janë pasojat në rast të shkeljeve ose mosrespektimit të të drejtave të pandehurit.

Në këtë modul pjesa e ushtrimit do të zbatohet duke ju ofruar pjesëmarrësve shembuj nga praktika përkitazi me pozitën e të pandehurit në faza të ndryshme të procedurës në mënyrë që pjesëmarrësit përmes diskutimeve të identifikojnë së për cilën fazë të procedurës është fjala, duke e identifikuar pozitën e të pandehurit me fazën konkrete të procedurës.

**Kohëzgjatja:** 5 sesione trajnimi (15 orë trajnimi)

### 9.3.6 Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale

Një ndër provat e rëndësishme që shërben për të vërtetuar një gjendje faktike në mënyrë të plotë dhe e drejtë në një çështje penale është edhe dëshmia e dëshmitarit dhe të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit. Gjithashtu një çështje mjaft më rëndësi në procedurën penale është edhe trajtimi i dëshmitarëve dhe të dëmtuarve që kanë nevojë për mbrojtje për shkak të kanosjes së rrezikut serioz për atë dëshmitar apo familjen e tij dhe në këto raste paraqitet nevoja e ndërmarrjes së veprimeve nga të gjitha institucionet e implikuar në procedurën penale siç janë: policia, prokuroria dhe gjykata.

Përmes këtij moduli synohet që pjesëmarrësit të mësojnë për llojet e dëshmitarëve, dallimin në mes tyre, mbrojtjen dhe mënyrat e intervistimit të dëshmitarëve, përpilimin e procesverbaleve për intervistimin e dëshmitarëve si dhe rastet kur dëshmia e dëshmitarit konsiderohet si provë e papranueshme në procedurën penale.

Gjithashtu një pjesë e këtij moduli do t'i kushtohet edhe të dëmtuarit i cili mund të jetë jo vetëm palë në procedurë por edhe dëshmitar. Në këtë modul do ti kushtohet një vëmendje të drejtave të të dëmtuarit siç është e drejta në kompensimin e dëmit dhe shumë të drejta tjera që janë parashikuar me kodin e ri të procedurës penale të Republikës së Kosovës.

**Kohëzgjatja:** 5 sesione trajnimi (15 orë trajnimi)

### 9.3.7 Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Negocimi i Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë është një institut juridik relativisht i ri i paraparë me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, gjë e cila e shtron nevojën e diskutimit dhe trajtimit të këtij instituti në mënyrë specifike e veçanërisht për juristët e rinj, në këtë rast për gjyqtarët e sapoemëruar.

Nëpërmjet këtij moduli do të synohet që pjesëmarrësve t'iu ofrohen njohuri lidhur me rregullativën ligjore e cila rregullon pranimin e fajësisë dhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë, arsyet themelore për aplikimin e këtij instituti,, çështjet kontestuese që paraqiten në praktikë, zgjidhjeve të ndryshme të ofruara dhe skepticizmit të shprehur madje edhe nga komuniteti

juridik ndaj këtij instituti të ri penalo-juridik.

Gjatë trajnimit pjesëmarrëseve do t'iu ofrohen shembuj e formular për aplikimin e drejtë të këtij instituti, i cili sadopak do tu ndihmoj veçanërisht gjyqtarëve të sapoemëruar të cilët për herë të parë do të ndeshen me nevojën e aplikimit të këtyre dispozitave si dhe nevojën e unifikimit të praktikës, nat-

yrisht duke respektuar specifikat e secilës lëndë në veçanti.

Pjesëmarrësve do t'i prezantohet praktika aktuale gjyqësore në Kosovë, rajon dhe më gjerë përkitazi me institutin e marrëveshjes, si dhe do t'iu jepen detyra konkrete-ushtrime me qëllim të ngritjes së shkathtësive praktike në aplikimin e këtij instituti.

**Kohëzgjatja:** 3 sesione trajnimi (9 orë trajnimi)

### 9.3.8 Administrimi i procedurës penale

Duke pasur parasysh rëndësinë e temave që do të zhvillohen në këtë modul, kohën e kufizuar për prezantim dhe me cilat vështirësi më së shumti ballafaqohen gjykatat dhe prokuroritë në punën e tyre për temat që do të shtjellohen gjatë trajnimit do të synojmë që pjesëmarrësit të njoftohen, sa më afër dhe të qartësohen sa më shumë që është e mundur këto institute të KPPK-së.

Në kuadër të këtij moduli do të elaborohen parashtresat, afatet si dhe marrja dhe komunikimi i vendimeve, dërgimi i shkresave, ekzekutimi i vendimeve dhe dispozitat tjera të KPPK-së.

**Kohëzgjatja:** 2 sesione trajnimi (6 orë trajnimi)

### 9.3.9 Shqyrtimi fillestar i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor

Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP) me një numër të konsiderueshëm të dispozitave ligjore e rregullon shqyrtimin fillestar, shqyrtimin e dytë dhe shqyrtimin gjyqësor. Shqyrtimi fillestar dhe shqyrtimi i dytë janë institute të reja që janë parashikuar në KPP.

Në këtë aspekt, në këtë modul trajnues janë trajtuar temat që kanë të bëjnë me shqyrtimin fillestar, kundërshtimin e provave, kërkesën për hedhjen e aktakuzës, aktvendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues ose të kryetarit të trupit gjykues, shqyrtimin e dytë, përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor, publicitetin e shqyrtimit gjyqësor, zbatimin e shqyrtimit gjyqësor, parakushtet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, shtyrjen, ndërprerjen dhe afatet e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor, etj.

**Kohëzgjatja:** 6 sesione trajnimi (18 orë trajnimi)

### 9.3.10 Marrja dhe komunikimi i vendimeve dhe dërgimi i shkresave

Në këtë modul të trajnimit do të flitet për llojet dhe marrjen e vendimeve nga ana e gjykatës, procedurat për marrjen e vendimeve, komunikimin e tyre si dhe për dërgimin e shkresave, ku do të flitet për mënyrën e dërgimit të shkresave për dorëzimin personal, alternativ, procedurë e dorëzimit, shkresat që duhet të dorëzohen personalisht, për dërgimin e shkresave në rrethana të veçanta, dërgimi dhe dorëzimi i shkresave pjesëmarrësve tjerë në procedurë.

**Kohëzgjatja:** 1 sesion trajnimi (3 orë trajnimi)

### 9.3.11 Shpenzimet e procedurës dhe kërkesat pasurore juridike

Temat që do të shqyrtohen në këtë modul kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe kërkesat pasurore juridike në procedurë penale. Të gjithë e dinë se çdo procedurë gjyqësore qoftë penale apo civile, natyrisht që ka edhe koston e vet të shpenzimeve, për të cilat duhet gjetur edhe burimet nga të cilat do të paguhen ato shpenzime.

Në procedurë penale çështja e shpenzimeve procedurale është më e komplikuar se në procedurat tjera ngase veprimet procedurale ndërmerren nga organet kompetente në kuadër të detyrës zyrtare, e që çdo veprim procedural e ka edhe koston e vet. Ky modul do të trajtoj çështjet se çka përfshihet në shpenzime procedurale, kur vendoset për shpenzimet në fjalë dhe kush duhet të obligohet që t'i paguaj shpenzimet procedurale.

Po ashtu në kuadër të këtij moduli do të trajtohen edhe kërkesat pasurore juridike, që po ashtu është temë e një rëndësie të veçantë ngase parimisht në një çështje penalo-juridike, shpeshherë ndodh të zbatohen edhe dispozitat e procedurës civile, gjë që në këtë rast gjykata është e obliguar ta bëjë këtë në procedurë penale për vendosje të kërkesës pasurore juridike. Përkitazi me këtë do të trajtohet mënyra e vendosjes së kërkesave pasurore juridike që janë pasojë e kryerjes së veprës penale e për të cilat palët paraqesin kërkesat e tyre në procedurë penale.

**Kohëzgjatja:** 1 sesion trajnimi (3 orë trajnimi)

### 9.3.12 Procedura sipas mjeteve juridike

Një prej vendimeve më të rëndësishme të cilën gjykata e merr, është aktgjykimi. E tërë procedura e cila zhvillohet ndaj një personi për të cilin dyshohet se ka kryer vepër penale, në shkallën e parë përfundon me aktgjykim, përveç rasteve kur procedura nuk arrin në fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe përfundon në ndonjë mënyrë tjetër. Rëndësia e këtij vendimi të gjykatës është shumë e madhe si për gjykatën ashtu edhe për palët në procedurë. Për këtë arsye Kodi i Procedurës Penale përmban një mori dispozitash lidhur me mënyrën e marrjes dhe

shpalljes së aktgjykimit, përmbajtjen e tij, llojet e aktgjykimit, si përpilohet ai, afatet etj.

Megjithatë, aktgjykimi i shkallës së parë nuk është vendim i cili një herë i marr është definitiv. Përkundrazi, aktgjykimi i shkallës së parë mund të kundërshtohet me ankesë, si mjet i rregullt juridik. Kjo është e arsyeshme sepse aktgjykimi mund të ketë të meta ligjore të cilat, sipas ankesës së ushtruar, shqyrtohen nga gjykata e shkallës së dytë ashtu që aktgjykimi, nëse nuk vërtetohet, mund të

ndryshohet apo të anulohet dhe çështja sërish t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë.

Ankesa është i vetmi mjet i rregullt juridik sepse ushtrohet kundër aktgjykimit i cili nuk ka marr formën e prerë. Mirëpo, ekzistojnë edhe mjetet tjera juridike, të cilat quhen mjete të

jashtëzakonshme juridike, të cilat mund të ushtrohen kundër aktgjykimit, i cili e ka marrë formën e prerë.

Të gjitha këto, mjete juridike, për shkak të rëndësisë së tyre, meritojnë një vend të veçantë në trajnimin e gjyqtarëve të sapoemëruar.

**Kohëzgjatja:** 2 sesione trajnimi (6 orë trajnimi)

### 9.3.13 Procedurat e veçanta sipas KPPK

Procedurat e veçanta sipas Kodit të Procedurës Penale dallojnë nga procedurat e rregullta në procedurën penale, prandaj si të tilla kërkojnë një vëmendje shtesë për profesionistët që aplikojnë këto procedura, veçanërisht për gjyqtarët e sapoemëruar.

Ky modul do të trajtoj procedurat që kanë të bëjnë me dhënien e urdhrit ndëshkimor, shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, ndaj personave që kanë kryer vepër penale nën ndikimin e alkoolit ose të drogës, për kryerësit me çrregullime mendore, revokimin e dënimeve alternative, vendimin për shlyerjen nga evidenca e të dënuarve, kompensimin e dëmit, rehabilitimin, dhe ushtrimin e të drejtave tjera të personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye, dhe procedurën për dhënien e letërreshtimit dhe të shpalljeve publike.

**Kohëzgjatja:** 2 sesione trajnimi (6 orë trajnimi)

### 10.3.14 Provat në procedurën penale

Rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe fajësia e të pandehurit mund të përcaktohen vetëm me anë të provave. Për tu shqiptuar një vendim i drejtë dhe ligjor në procedurë penale procesi i të provuarit (argumentimit) në drejtim të vërtetimit të fakteve relevante juridike në një çështje penale është shumë i rëndësishëm. Andaj pjesë e këtij moduli është në përgjithësi procesi i të provuarit gjatë fazës së hetimeve, roli i provave në procedurë në ndriçimin e një çështje penale, subjektet proceduralë të cilët mund të mbledhin dhe sigurojnë prova në këtë fazë të procedurës, provat e papranueshme.

Pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të njoftohen me llojet e provave të cilat mund të sigurohen gjatë hetimeve me veprime të caktuara hetimore, me specifika të veçanta të tyre, lloji dhe klasifikimi i tyre, marrjen e provës në procedurë para-prake dhe rregullat e përgjithshme për prova. Po ashtu pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të njoftohen edhe me risitë dhe ndryshimet që kanë rezultuar me hyrjen në fuqi të Kodit të Procedurës Penale.

**Kohëzgjatja:** 6 sesione trajnimi (18 orë trajnim)



## 9.4 E drejta civile, administrative dhe ekonomike

### 9.4.1 E drejta civile

Shkenca mbi të drejtën civile hynë në shkencat më të vjetra dhe më të zhvilluara të drejtësisë, e cila rregullon marrëdhëniet shoqërore duke caktuar norma, pra, kemi të bëjmë me normat e të drejtës civile. Çdo marrëdhënie civile juridike, është raport konkret, i caktuar jetësor, më saktësisht raport shoqëror.

Në kuadër të këtij moduli do të trajtohen burimet e së drejtës civile – prakti-

ka gjyqësore, objekti i së drejtës civile, krijimi dhe mbarimi i raporteve juridike – ndarja e fakteve juridike, modifikimi i punëve juridike – kushti dhe afati, posedimi, llojet dhe mbrojtja e tij, të drejtat absolute dhe relative, përfaqësimi me prokurë (autorizim), punët juridike të njëanshme dhe të dyanshme, punët juridike të pa vlefshme, veprimet e palejueshme (deliktet), pasurimi i pabazë dhe mbrojtja e të drejtave.

**Kohëzgjatja:** 6 sesione trajnimi (18 orë trajnim)

### 9.4.2 Procedura Kontestimore - pjesa e parë

Ky modul është hartuar në mënyrë që të jetë një kornizë që shpjegon konceptet kryesore të Procedurës Civile pjesa e parë e saj, e cila si pjesë e së drejtës pozitive i përfshinë të gjitha rregullat juridike në bazë të së cilave zhvillohet realizimi i të drejtave subjektive nga marrëveshjet juridiko-civile në jetën e përditshme.

Një vëmendje e posaçme do t'i kushtohet parimeve themelore të procedurës kontestimore, palëve dhe përfaqësuesve të tyre në procedurë, format e veprimit procedural, afateve brenda të cilëve mund dhe duhet të kryhen veprimet e caktuara procedurale si dhe çështje të tjera të rëndësishme të cilat profesionistët e lëmit juridik do t'i hasin në praktikën e tyre.

**Kohëzgjatja:** 10 sesione trajnimi (30 orë trajnim)

### 9.4.3 Procedura kontestimore - pjesa e dytë

Procedura kontestimore-pjesa e dytë, përmban dispozita ligjore që rregullojnë çështjet e rrjedhës së procedurës në gjykatën e shkallës së parë dhe atë duke filluar prej paraqitjes së padisë në gjykatë, bashkëndërgjyqësisë, pjesëmarrja e personit të tretë në kontest-procedurë, ndërprerja dhe pushimi i procedurës kontestimore, ndihma juridike, mosrespektimi i gjykatës, sigurimi i kërkesëpadisë, mjetet provuese dhe marrja e provave, përgatitja e shqyr-

timit kryesor, ndërmjetësimi dhe pajtimi gjyqësor, shqyrtimi kryesor dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Me shfrytëzimin e metodës së kombinuar me ligjërime, bashkëbisedim dhe punë praktike e duke i shfrytëzuar edhe burimet tjera juridike pjesëmarrësit do të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi profesionale për zbatimin praktik të Ligjit të Procedurës Kontestimore – Pjesa e dytë.

**Kohëzgjatja:** 10 sesione trajnimi (30 orë trajnim)

### 9.4.4 Procedura jokontestimore

E drejta procedurale jokontestimore është sistem rregullash procedurale, me të cilat rregullohet struktura e procedurës jokontestimore, pozita dhe roli i subjekteve procedurale, aktivitetet procedurale të tyre, si dhe raportet reciproke midis tyre. Ajo nuk përbën një tërësi unike dhe homogjene, sepse përbëhet nga rregullat procedurale të diferencuara, me të cilat rregullohet dhënia e mbrojtjes juridike në çështjet e caktuara juridiko-civile, të cilat nuk zgjidhen sipas rregullave të procedurës kontestimore.

Në këtë modul do të trajtohen dispozitat e përgjithshme të ligjit të procedurës jokontestimore, shpallja e zhdukjes së një personi- procedura e shpalljes së personit të zhdukur si i vdekur dhe procedura e të provuarit të vdekjes, caktimi i lartësisë së kompensimit për paluajtshmërinë e ekspropriuar dhe rregullimi i megjës - ndarja fizike.

**Kohëzgjatja:** 3 sesione trajnimi (9 orë trajnim)

#### 9.4.5 Procedura përmbarimore

Ligji për procedurën përmbarimore rregullon procedurën përmes së cilës gjykatat dhe përmbaruesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbaruese dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe. Nga kjo rrjedh se përveç gjykatave kompetent për përmbarim janë edhe përmbaruesit privat. Kosova gjatë reformimit të sistemit të drejtësisë ka bërë harmonizimin e ligjeve me ato të BE-së dhe në kuadër të kësaj në Ligjin për procedurën përmbarimore ka marrë për bazë rekomandimet e Këshillit të Evropës për përmbarimin. Rekomandimi (dhe udhëzimet) bazohet në efikasitet, transparencë dhe kuptim

të lehtë të tij.

Sistemi privat i përmbarimit ka përparësinë e heqjes së përgjegjësisë së menaxhimit të procesit të përmbarimit nga gjyqtarët dhe zyrtarët përmbarues të gjykatave. Këto përgjegjësi i kalojnë agjenteve privat. Roli i gjykatave mbetet mjaftë i rëndësishëm sepse çështjet më të ndjeshme si janë çështjet familjare mbesin kompetence ekskluzive të gjykatave, po ashtu mjetet juridike mbesin në vendosje të gjykatave si dhe funksion tjetër i rëndësishëm është mbikëqyrja sepse palët të cilët mendojnë se agjenti privat ka shkelur ndonjë të drejtë të tyre mund t'i drejtohen gjykatës.

**Kohëzgjatja:** 4 sesione trajnimi (12 orë trajnim)

#### 9.4.6 E drejta administrative

E drejta administrative, përkufizohet si tërësi e normave juridike me të cilat përfshihet rregullimi i pozitës dhe funksionimi i organeve të administratës, raportet e administratës me organet tjera të pushtetit shtetëror, punët administrative, organizatat administrative, kontrolli administrativ, kontrolli politik i organeve të administratës etj.

Dispozitat me të cilat rregullohet procedura administrative përmbajnë norma me të cilat rregullohet kompetenca e organit të administratës publike, që do të vendos në një çështje administrative. Në këtë modul do të trajtohet procedura administrative, nxjerrja e aktit administrativ, ankesa

dhe ekzekutimi i vendimit përfundimtar, konflikti administrativ dhe procedura paraprake në konfliktin administrativ, seanca e shqyrtimit kryesor, aktgjykimi dhe mjetet juridike në procedurën e konfliktit administrativ.

Sistemi tatimor në Kosovë është themeluar gjatë dekadës së fundit dhe është ende në zhvillim e sipër. Gjatë vitit 2015 legjislacionit tatimor në Kosovë është ndryshuar dhe harmonizuar me legjislacionin e BE-së. Mbështetur në këtë fakt, në kuadër të këtij moduli do të trajtohen edhe kompetencat dhe procedurat pranë Divizionit Fiskal në kuadër të Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

**Kohëzgjatja:** 5 sesione trajnimi (15 orë trajnim)

#### 9.4.7 E drejta e detyrimeve

Në këtë modul janë përfshirë parimet themelore të së Drejtës së Detyrimeve, të cilat kanë ndikim vendimtar lidhur me pjesën e posaçme të së Drejtës së Detyrimeve. Esenca e prezantimit të parimeve themelore i referohet faktit se duke i respektuar parimet themelore me përpikëri, janë mundësit minimale për paraqitjen e kontesteve gjyqësore. Po ashtu do të trajtohen institutet e ndryshme juridike të rëndësishme në të drejtën e detyrimeve duke filluar nga kompensimi i dëmeve të shkaktuar, lidhur me përgjegjësin objektive dhe subjektive, përgjegjësia nga baza objektive dhe subjektive si dhe format tjera të kompensimit të dëmit.

Pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të kenë rastin që përmes shembujve praktik të përpilojnë padi, dhe aktgjykime për çështjet lidhur me bazat e ndryshme juridike.

**Kohëzgjatja:** 10 sesione trajnimi (30 orë trajnimi)

#### 9.4.8 E drejta ekonomike

E drejta ekonomike është paraqitur dhe është zhvilluar si një domosdoshmëri e nevojave dhe praktikave të komunitetit të tregtarëve, gjegjësisht e mundësive që duhej të shfrytëzoheshin dhe problemeve që duhej të zgjidheshin. Në ditët e sotme e drejta ekonomike është njëra nga degët më të rëndësishme të së drejtës, si në vendin tonë, ashtu edhe më gjerë.

Mosmarrëveshjet apo kontestet që paraqiten në jetën ekonomike, të cilat eventualisht nuk mund të zgjidhen përmes negociatave, marrëveshjeve apo metodave tjera alternative, zakonisht paraqiten pran Departamentit për Çështje Ekonomike. Duke e nisur nga rëndësia e këtyre rasteve, nga reflektimet e tyre që mund të kenë në jetën e ekonomike të vendit, shpeshherë edhe nga vlerat e larta të këtyre kontesteve, rrjedh përfundimi se gjyqtarët duhet të jenë në nivelin më të lartë të mundshëm të profesionalizmit dhe efikasitetit.

Në hartimin e këtij programi të trajnimit, është marrë parasysh fakti se audienca që ndjek këtë trajnim, ka njohuri të përgjithshme të mjaftueshme nga kjo fushë e së drejtës.

Në programin e këtij trajnimi janë përfshirë temat dhe çështjet kryesore të cilat ndërlihen me praktikat aktuale të Departamentit për Çështje Ekonomike, me qëllim që gjyqtarët e sapoemëruar të thellojnë njohuritë e tyre dhe të marrin informacionet e nevojshme.

Në kuadër të këtij moduli do të trajtohen e drejta ekonomike dhe praktika gjyqësore e saj, kontrata e ndërtimit, pronësia intelektuale, kontrata e shitjes në ekonomi, procedura përbarimore ndaj shoqërive tregtare, arbitrazhi dhe procedurat gjyqësore të ndërlidhura me të, dhe falimentimi i shoqërive tregtare.

**Kohëzgjatja: 5 sesione trajnimi (15 orë trajnim)**

#### 9.4.9 E drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera të përafërta

Në kuadrin e marrëdhënieve të përgjithshme shoqërore kanë lindë dhe janë zhvilluar edhe marrëdhëniet shoqërore- pronësore me karakteristika dhe përmbajtje të veçanta, të cilat janë rregulluar me normat të veçanta juridike. Për rrjedhojë e drejta e pronësisë mund të përkufizohet si degë e veçantë e së drejtës e cila përmban tërësinë e normave juridike më të cilat rregullohen marrëdhëniet e pronësisë.

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi do të njoftohen me tematika që ndërlihen

me të drejtën e pronësisë, bashkëpronësinë dhe pronësinë e përbashkët, të drejtën fqinjësore, imisionet dhe fitimin e pronësisë në përgjithësi. Ndër të tjera, do të trajtohen edhe çështje lidhur me mbrojtjen e pronësisë, padinë e reividnikimit, publiciane, negatorë, mbrojtjen e posedimit, ndërprerjen e servituteve sendore dhe mbrojtjen e servituteve sendor si dhe humbjen e pronësisë.

**Kohëzgjatja: 10 sesione trajnimi (30 orë trajnim)**

#### 9.4.10 E drejta e trashëgimisë

Çështjet e rregullimit të trashëgimisë në Kosovë gjenden në një fazë tejet të rëndësishme të zhvillimit të tyre. Problematike këtë fushë të së drejtës e bënë ekzistimi i relikteve të së drejtës zakonore në jetën e përditshme juridike në disa rajone me pak të zhvilluara të Kosovës, ekzistimi edhe më tutje i pasurisë së përbashkët të familjeve të mëdha në fshat, çështjet e avancimit të së drejtës së femrës për të trashëguar, nevoja e ngritjes së kulturës juridike tek qytetarët, zvarritja e zgjidhje së rasteve gjyqësore në gjykata për shkak të shumësisë së lëndëve, nevoja e ap-

likimit të metodave të ndërmjetësimit etj. Për të gjitha këto shkenca jonë juridike, praktika jonë gjyqësore dhe institucionet e bërjes së ligjit duhet të ofrojnë zgjidhje adekuate.

Ky modul është hartuar në atë formë që të iu shërbejë gjyqtarëve të sapoemëruar që të avancojnë njohuritë mbi bazat e thirrjes në trashëgimi, cedimin e pasurisë për së gjalli, përjashtimin nga trashëgimia, borxhet e trashëgimlënësit, pjesën e domosdoshme të trashëgimisë, dhe trashëgimin me testament.

**Kohëzgjatja:** 2 sesione trajnimi (6 orë trajnim)

#### 9.4.11 E drejta e punës

Marrëdhënia e punës konceptohet si marrëveshje me shkrim ose rregullim kontraktual ndërmjet një punëdhënësi dhe të punësuarit për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi specifike nga i punësuarit nënë mbikëqyrjen e punëdhënësit, kundrejt një pagese të akorduar, zakonisht në formë të parave.

Të drejtat nga marrëdhënia e punës paraqesin ndër të drejtat themelore të njeriut. Këto të drejta shpesh shkelen nga punëdhënësit dhe është e domosdoshme që gjykata të u ofrojë mbrojtje.

Në kuadër të këtij moduli do të trajtohen mbrojtja gjyqësore e ofruar nga gjykata në çështjet të cilat fillojnë me padi dhe rregullohen me Ligjin e Punës, procedurën e cila aplikohet lidhur me kategoritë e shërbyesve civil, kompetencat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe kompetencën e gjykatës lidhur me këto çështje, siguria dhe mbrojtja në punë si dhe kompensimi i dëmit të shkaktuar me rastin e lëndimit në vendin e punës.

**Kohëzgjatja:** 3 sesione trajnimi (9 orë trajnim)

#### 9.4.12 E drejta familjare

Mbrojtja juridike e familjes ka rëndësi të veçantë, edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban dispozita të cilat i referohen të drejtës familjare dhe martesore, përmes të cilave e rendit shtetin tonë në grupin e vendeve me rregullativën juridike familjare të harmonizuar me legjislacionin ndërkombëtar. Gjithashtu Kosova ka miratuar Ligjin për Familjen, i cili konsiderohet si një përpjekje për të krijuar një bazë të re ligjore me të cilën do të respektohen parimet bazë të standardeve ndërkombëtare për rregullimin e marrëdhënieve familjare. Përmes këtij

ligji shteti dhe shoqëria në përgjithësi kanë për detyrim të respektojnë të drejtat që rrjedhin nga lëmia familjare.

Moduli do të trajtoj të drejtën familjare, kuptimin e familjes, të drejtën martesore, të drejtat dhe detyrat e bashkëshortëve, zgjidhjen e martesës, procedurën e shkurorëzimit, detyrimin për ushqim dhe të drejtën prindërore, kundërshtimin dhe vërtetimin e amësisë apo të atësisë, birësimin, marrëdhëniet pasurore në mes bashkëshortëve dhe dhunën në familje.

**Kohëzgjatja:** 6 sesione trajnimi (18 orë trajnim)

#### 9.4.13 Marrja dhe administrimi i provave në procedurën civile

Procedura e provave është një nga gurë-themelet e procesit gjyqësor. Pa dëshmi të mjaftueshme, provuese për çështjet kontestuese në një rast, gjyqtari nuk do të jetë në gjendje të bëjë gjetjen e fakteve që duhet të mbështesin një aktgjykim të arsyetuar qartë dhe me kujdes. Të provuarit e përbëjnë veprimet procedurale të subjekteve kryesore me të cilat bëhet propozimi, zgjedhja, mbledhja, ekzaminimi dhe çmuarja e mjeteve provuese me qëllim të vërtetimit të fakteve relevante në të cilat mbështetet kërkesa e palëve.

Në kuadër të këtij moduli do të trajtohen barra e të provuarit, faktet që nuk kanë nevojë të provohen, marrja e provave, sigurimi i provës (paraprova), mjetet provuese siç janë: këqyrja e vendit, shkresat, dëshmitarët, ekspertët dhe dëgjimi i palëve.

**Kohëzgjatja:** 5 sesione trajnimi (15 orë trajnim)

## 9.5 Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare

### 9.5.1 Rregullat e Komunikimit

Konteksti i komunikimit në gjykatë ndryshon, por duket se hyn në dy kategori themelore, të cilat janë të përshkruara më poshtë: komunikimi i brendshëm dhe komunikimi i jashtëm. Në kuadër të këtij moduli të trajnimit do të zhvillohet një diskutim për karakteristikat e një komunikuesi efektiv, do të bëhet një vetëvlerësim i shkathtësive të komunikimit të pjesëmarrësve dhe një shqyrtim i rasteve relevante për studim që ua mundësojnë pjesëmarrësve t'i zbatojnë praktikatat më të mira të komunikimit në një mjedis real të punës.

**Kohëzgjatja:** 2 sesione trajnimi (6 orë trajnimi) dhe 4 orë trajnimi online (mësim nga distanca)

### 9.5.2 Etika Profesionale

Në çdo vend të botës gjyqtarët dhe prokurorët i përkasin elitës së shoqërisë. Çdo ditë, këta njerëz kryejnë veprime dhe marrin vendime të rëndësishme për fatin e bashkëqytetarëve të tyre. Natyrisht që ky pushtet i madh nuk mund t'iu besohet atyre që nuk ofrojnë garanci të mjaftueshme morale e profesionale. Pikërisht këtu e ka origjinën edhe rregullimi ligjor e profesional i etikës gjyqësore e prokuroriale tek i cili bazohet i gjithë sistemi ligjor.

Moduli i etikës profesionale për gjyqtarë, përveç dijeve, synon të përçojë edhe disa shprehje themelore për mënyrën e të menduarit dhe të vepruarit të gjyqtarëve të sapoemëruar, pa të cilat ushtrimi korrekt i profesionit do të ishte i pamundur. Në këtë format gjyqtarët dhe prokurorët shqyrtojnë

problemet etike dhe mënyrën sesi ato manifestohen në jetën e tyre profesionale dhe diskutojnë në lidhje me mënyrat më efikase për të parandaluar shkeljet etike. Trajnimi i gjyqtarëve të sapoemëruar në lidhje me përmbajtjen dhe kuptimin e normave të etikës profesionale i ndihmon ata të krijojnë një aparat konceptual me anë të të cilit të analizojnë dhe zgjidhin çështjet etike me të cilat do të ballafaqohen gjatë punës së tyre.

Meqenëse etika profesionale nuk është veçse një derivat i etikës dhe moralit të shoqërisë në përgjithësi, është esenciale që trajnimi i gjyqtarëve të jetë i përqendruar sa më shumë të jetë e mundur rreth rasteve konkrete të nxjerra nga realiteti i jetës në Kosovë.

**Kohëzgjatja:** 10 sesione trajnimi (30 orë trajnimi)



### 9.5.3 Menaxhimi i rasteve

Menaxhimi është proces i planifikuar i aktiviteteve për arritjen e qëllimeve të caktuara në lëmi apo sfera të ndryshme të jetës. Nga ky definicion shumë i thjeshtë shihet se sa dhe pse është i rëndësishëm ky proces edhe për gjyqtarët. Gjykatat ekzistojnë për të ofruar zgjidhjen e drejtë dhe në kohë të mosmarrëveshjeve që sillen para tyre. Prandaj, funksioni më qendror i cilëso gjykatë është menaxhimi i rasteve të asaj gjykate. Teoria moderne për menaxhimin e rasteve është që gjyqtarët, së bashku me stafin mbësht-

etës, duhet që në mënyrë aktive të monitorojnë dhe të kontrollojnë lëvizjen e lëndëve të pakryera para kësaj gjykate.

Në këtë modul do të trajtohet qëllimi i punës së gjykatave dhe metodat themelore në planifikimin dhe menaxhimin e rasteve dhe kontrollimi i shtyrjeve, udhëheqësia dhe masat e performancës së gjykatës, në mënyrë që pjesëmarrësit të përfitojnë nga mësimi i praktikave më të mira në këtë fushë.

**Kohëzgjatja:** 3 sesione trajnimi (9 orë trajnimi)

### 9.5.4 Ngritja e shkathtësive sociale të gjyqtarëve

Duke pasur parasysh nevojën e kompletimit të gjyqtarëve me informata, të dhëna e instruksione nga fusha sociale si segment i nevojshëm për një performancë më të avancuar gjatë ushtrimit të punës së tyre, ky modul është koncipuar si rast e mundësi e mirë e kompletimit me këtë dimension tematik aq të nevojshëm edukues për profilin e gjyqtarëve bashkëkohor.

Pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të njoftohen me nocione, kategori e përmbajtje psikosociale, pastaj veçori e tipare të personalitetit, karakteristika e segmente të jetës sociale të individit në mjedisin social, faktorët interferues në mjedisin social stabil, faktorët degjenerues në socium.

Së këndejmi ata do të pajisen me informata dhe do të zhvillojnë kapacitetet sociale në komunikim me subjekte e individ të ndryshëm gjatë ushtrimit të profesionit të ndjeshëm siç është puna e gjyqtarit.

**Kohëzgjatja:** 3 sesione trajnimi (9 orë trajnimi)

### 9.5.5 Arsyetimi i vendimeve gjyqësore

Ky modul ka për qëllim të ndihmoj gjyqtarët e sapoemëruar në ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale në drejtim të arsyetimit të akteve të hartuara. Përveç udhëzimeve teorike që do të ofrohen në përgjithësi për arsyetimin e akteve të hartuara nga gjyqtari, do diskutohen në sesione të veçanta edhe rastet praktike të punuar sipas metodave të caktuara të arsyetimit dhe shkrimit ligjor.

Përmes rasteve konkrete si nga fusha penale ashtu edhe nga fusha civile, gjyqtarët do të kenë mundësi që duke zbatuar kërkesat e ligjeve nga procedura penale dhe civile të japin konkluzionet e

tyre për vendosjen e supozuar meritore. Përveç tjerave ky modul ofrohet ngase është identifikuar nevojë e gjyqtarëve në veçanti për ngritje të kapaciteteve profesionale në fushën e arsyetimit të vendimeve.

Shkrimi dhe arsyetimi ligjor paraqet standard vlerësimi të punës së gjyqtarit. Në këtë kuptim shkrimi dhe arsyetimi ligjor në punën e gjyqtarëve përfaqëson një objektiv jo lehtë të arritshëm. Prandaj përmes këtij moduli synohet që përmirësohet cilësia e arsyetimit në punën e gjyqtarëve të sapoemëruar.

**Kohëzgjatja:** 10 sesione trajnimi (30 orë trajnimi)

### 9.5.6 Menaxhimi i stresit

Ky modul e trajton temën e gjerë të mirëqenies personale dhe menaxhimit të stresit. Gjyqësori ballafaqohet vazhdimisht me ngarkesa në punë, kritikë nga publiku, kufizime të ashpra buxhetore, përgjegjësi të jashtëzakonshme dhe plot tension.

Studimet kanë vërtetuar se puna e lidhur me stresin është një përcaktues kognitiv, emocional dhe simptoma të sjelljeve të tilla si përqendrimi i zvogëluar, vendimmarrja, dhe duke shprehur bezdi ndaj avokatëve dhe palëve ndërgjyqësore. Një studim ka identifikuar simptomat psikofiziologjike të mëposhtme që lidhen me stresin si: shqetësimet e funksionit të traktit digjestiv (problem në tretjen e ushqimit), duke përfshirë të përziëra; dhimbje gjoksi zakonisht përshkruhet për mosfunksionim të zemrës; vështirësi në frymëmarrje apo ajri i pamjaftueshëm në mushkëri; vështirësi në fjetje; dhe një

ndjenjë e të qenit të tensionuar apo të shqetësuar. Ata gjithashtu kanë identifikuar simptomat që lidhen me konflikte ndërpersonale siç janë: shpërthime të pazakonta, temperamentit, argumente të shpeshta, një ndjenjë e izolimit, dhe një ndjenjë e ngritur e vetë-vetëdijes në situata shoqërore.

Ky program interaktiv u ofron pjesëmarrësve mundësinë për të identifikuar shkallën e stresit në jetën e tyre, pikat e forta të tyre, faktorët e rrezikut, si dhe fushat për realizimin e mundësive më të mira për mirëqenien e tyre. Ndër të tjera, trajnimi është dedikuar për të përmirësuar shëndetin, aftësitë njohëse, qëndrueshmërinë, kreativitetin dhe lumturinë.

**Kohëzgjatja:** 2 sesione trajnimi (6 orë trajnimi) dhe 5 orë trajnimi nga distanca

## 9.6 Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese

### 9.6.1 Kodi i Drejtësisë për të Mitur

Ky modul trajnues është hartuar me qëllim të ofrimit të njohurive themelore përfituesve të Programit të Trajnimit Fillestar lidhur me zbatimin praktik të Kodit të Drejtësisë për të Mitur të Kosovës (KDM). Nëpërmjet këtij trajnimi synohet që të definohen parimet themelore të KDM-së, të interpretohet qëllimi, llojet e masave dhe dënimeve të zbatueshme ndaj të miturve, masave dhe dënimeve për madhorë lidhur me veprat penale të kryera si të mitur, masat e diversitetit çdo herë kur plotësohen kushtet, të interpretohet qëllimi, llojet dhe kohëzgjatja e masave edukuese, masat edukative-institucionale, të analizohen masat alternative ndaj dënimit me burg për të mitur, dënimin me gjobë dhe urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, kushtet për shqiptimin e burgimit për të mitur.

**Kohëzgjatja:** 3 sesione trajnimi (9 orë trajnimi)

### 9.6.2 Ndërmjetësimi

Ndërmjetësimi është veprimtari jashtëgjyqësore që realizohet nga një person i tretë (ndërmjetësi) për zgjidhje të mosmarrëveshjeve ndërmjet subjekteve të së drejtës në pajtim me kushtet e parashikuara me ligj. Zbatimi i ndërmjetësimit në trajtimin e mosmarrëveshjeve në çështjet penale dhe civile përbën një alternativ konstruktive jashtëgjyqësore për arritjen e një zgjidhje të kënaqshme për palët e përfshira në mosmarrëveshje.

Përfshirja e ndërmjetësimit si institucion juridik dhe aplikimi i saj në procedurat gjyqësore është një mundësi relevante dhe shumë e rëndësishme në zgjidhjen e shumë lëndëve me të cilat gjykatat janë të stërngarkuara dhe do të arrihej efikasiteti i gjykatave duke u liruar nga lëndët e mundshme për zgjidhje me marrëveshje, kurse gjyqtarët të kenë kohë të mjaftueshme të merren me lëndë me të komplikuar që t'i kryejnë në një afat me të arsyeshëm dhe me kualitative.

**Kohëzgjatja:** 2 sesione trajnimi (6 orë trajnimi)

### 9.6.3 Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore

Duke pasur parasysh ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale lidhur me marrjen në pyetje dhe udhëheqjen e shqyrtimit gjyqësor është e nevojshme që gjyqtarët e sapoemëruar të trajnohen lidhur me zhvillimin e shkathtësive gjyqësore në përputhje me këto ndryshime. Në mënyrë specifike ngritja e shkathtësive do bëhet për fjalën hyrëse, marrjen e drejtpërdrejtë dhe të tërthorët në pyetje, vënien në dyshim, rehabilitimin dhe fjalën përfundimtare.

**Kohëzgjatja:** 12 ditë trajnimi (4 grupe)

### 9.6.4 Ligji për kundërvajtje

Duke pasur parasysh që vepra e kundërvajtjes është vepër që kryhet në shumë lëmi, rëndësinë e tyre, kohën e kufizuar për trajnim, do të synohet që pjesëmarrësit të njohohen me veprën e kundërvajtjes, dallimin me veprat e tjera, parimet e veprës dhe përcaktueshmërinë e veprës kundërvajtëse me dispozitat ligjore në fuqi.

Pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të njohohen me veprën e kundërvajtjes, çka e dallojnë nga veprat tjera, dhe cilat janë elementet e përbashkëta me veprat tjera (vepra penale, delikti ekonomik etj.).

Gjithashtu pjesëmarrësit do të njohohen me parimin e ligjshmërisë, dhe rëndësinë e tij në përkufizimin e veprës së kundërvajtjes.

**Kohëzgjatja:** 2 sesione trajnimi (6 orë trajnimi)

## 9.7 Mësimi në distancë

### 9.7.1 Gjuha angleze

E-moduli lidhur me anglishten ligjore është modul edukativ për t'u përdorur nga profesionistët ligjorë të cilët dëshirojnë të përmirësojnë aftësitë e tyre komunikuese në gjuhën angleze gjatë aktiviteteve të tyre të përditshme në gjyqësor. Ai është i dizajnuar për të plotësuar nevojat e komunikimit dhe i pajis profesionistët ligjor me bazat e terminologjinë ligjore në gjuhën angleze.

**Kohëzgjatja:** 5 orë trajnimi nga distanca

### 9.7.2 Teknologjia informative

Ky modul ndihmon përfituesit që të kenë njohuri themelore lidhur me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Puna me kompjuter dhe njohja e mirë e programeve aplikative është bërë e domosdoshme për çdo vend pune, puna efikase me kompjuter është çelësi i suksesit për çdo individ.

Teknologjia e Informacionit ndihmon gjyqësorin të kryejë përgjegjësitë e saj në mënyrë të duhur, efikase e transparente, p.sh. përdorimi i TI-së zvogëlon mundësinë e dyfishimit të dokumenteve, në qoftë se një gjykatë ka një sistem të automatizuar kompjuterik për regjistrimin e rasteve atëherë mjafton që ky rast të regjistrohet njëherë dhe të përdoret sa herë që kemi nevojë p.sh për gjenerim të raportit të rastit, për gjenerimin e thirrjeve apo gjykimeve, për shkrime të ndryshme etj. Në këtë rast qasja në dokumente do të jetë shumë më e shpejtë.

Me përdorimin e TI-së rastet do t'i

kemi nën monitorim të vazhdueshëm duke nxjerr statistika të ndryshme. Me automatizime kompjuterike ne mund të bëjmë analiza statistikore me një shpejtësi dhe saktësi mjaft të madhe në krahasim me sistemet manuale. Udhëheqja e gjykatës mund t'i përdor këto analiza për të përmirësuar operacionet gjyqësore, planifikimet dhe punë të tjera që i takojnë gjyqësorit.

Me përdorimin e Teknologjisë së Informacionit sistemi gjyqësor është i arritshëm për të gjithë ata që kërkojnë shërbime gjyqësore, si dhe do të ofrohet cilësi më të lartë në drejtësi duke nxjerr llogaridhënie dhe transparencë e jo vetëm vendime të marra nën sundimin e ligjit.

Përdorimi i TI-së ndihmon gjyqësorin të përmbush objektivat e sistemit gjyqësor duke rritur efikasitetin e gjyqësorit, rritjen e qasjes në drejtësi, si dhe rritjen e cilësisë së drejtësisë.

**Kohëzgjatja:** 4 sesione trajnimi nga distanca

## 10. Përfundim

Programi i trajnimit fillestar reflekton nevojat për trajnim të gjyqtarëve të sapoemëruar dhe pritjet e institucioneve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në përgatitjen dhe zhvillimin e shkathtësive profesionale, etike dhe shkathtësive praktike, me qëllim që në përfundim të tij, këta përfitues të jenë të gatshëm për ushtrimin e plotë të funksionit të gjyqtarit në mënyrë profesionale, të pavarur dhe efektive.

Struktura e programit, modulet trajnuese dhe trajnimi praktik, reflektojnë synimet e përcaktuara të IGJK-së për zhvillim të kompetencave, duke u mbështetur në kohëzgjatjen e trajnimit të përcaktuar me ligj dhe duke marrë në konsideratë përgatitjen dhe përvojën e kaluar profesionale të përfituesve të cilët tashmë kanë kaluar të gjitha fazat e testimit dhe vlerësimit të kompetencave profesionale nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përkatësisht komisioneve përkatëse.

Miratuar nga Këshilli Drejtues i Institutit Gjyqësor të Kosovës me datën 06 shkurt 2017.



**AKADEMIA E DREJTËSISË**

**<https://ad.rks-gov.net>**

**[infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)**

**038 200 18 660**

**Adresa “Lagjja e Spitalit”**

**Rr. Muharrem Fejza p.n**

**Prishtinë, Republika e Kosovës**